

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 nga Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11) në bazë të nenit 25 paragrafi 2 dhe paragrafi 5 nga Ligji për arsim fillorë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 103/08, 33/2010, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/2014, 116/2014 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016), dhe në bazë të nenit 6 dhe nenit 7, paragrafi 1, alineja 4 nga Ligji i Byrosë për zhvillim të arsimit („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ nr. 37/06, 142/08, 148/09, 69/13, 120/13, 148/13, 41/2014 и 30/2016), ministria e arsimit dhe shkencës e vërtetoi programin mlsimorë nga *kimia* për klasë të IX të arsimit fillorë nëntëvjeçarë.

Cambridge International Examinations

Byroja për zhvillim të arsimit

PROGRAMI MËSIMORË

**KIMI**

**për klasë të IX**

arsimi fillorë nëntëvjeçarë

Shkup, mars viti 2016

## Hyrje

Programi mësimorë nga lënda e kimisë për klasë të nëntë të arsimit fillor nëntëvjeçarë është e marrë nga qendra ndërkombëtare për programet mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations) dhe është e përshtatur nga ana e Byrosë për zhvillim të arsimit. Aprovimi i përshtatjes së programit mësimorë është e fituar nga ekspertët e qendrës ndërkombëtare për programet mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations).

Ky program mësimorë i Kembrixhit përmban një tërësi të kuptueshme nga tërësitë graduale të të mësuarit nga lënda e kimisë në klasë të nëntë. Qëllimet e qartësojnë atë çka nxënësit duhet ta dinë ose duhet të jenë të aftë ta bëjnë në klasë të nëntë. Qëllimet e të mësuarit formojnë strukturën për ligjerim dhe mësim, por shërbejnë edhe si referim për verifikimin e aftësive dhe të kuptuarit e nxënësve

Programi mësimorë përmaban hulumtim shkencorë. Me hulumtim shkencor nënkuptohet shqyrtimi i ideve, dëshmi të vlerësimit, planifikim të punës hulumtuese dhe vërejtja dhe analiza e të dhënave. Qëllimet e hulumtimit shkencorë janë ndihmëse për kiminë ku koncentrohen në zhvillimin e vetëbesimit dhe interesit për dituri shkencore. Programi mësimorë është themel i fortë mbi të cilat fazat e mëtejme arsimore mund të rindërtohen..

Programi mësimorë i Kembrixhit bazohet në vlerat e Universitetit „Kembrixh“ dhe praktika më e mirë në shkolla. Programi mësimorë i kushtohet zhvillimit nxënësve të cilët kanë vetëbesim, janë përgjegjës, inovativ dhe aktiv. Ajo është e projektuar që ti kuç nxënësit në një përvojë arsimore aktive dhe kreative. Ky program mësimorë është në mënyrë të veçantë është e përshtatur për nxënësit e Republikës së Maqedonisë.

Programi mësimorë duhet të realizohet me fond prej 2 orë në javë, gjegjësisht 72 orë në vjetë.

Pjesët e programit mësimorë për notim, kushtet e hapësirave për realizimin e mësimit dhe normativi për kuadrin mësimorë janë të dhëna në nenin 25 paragrafi 5 të Ligjit për arsim fillor.

# Programi mësimorë për klasë të IX-të

## 1. 1. Fushat dhe rezultatet e pritura

### Hulumtim shkencorë

#### Idetë dhe dëshmitë

- Diskuton dhe shpjegon rëndësinë e pyetjeve, dëshmime dhe shpjegimeve duke përdorur shembuj historik dhe bashkëkohorë.
  - I verifikon shpjegimet duke i përdorur ato në parashtrimin e parakushteve, e mandej i evaluon në raport të dëshmimeve.
- Diskuton në mënyrën në të cilën sot shkencëtarët punojnë dhe si kanë punuar në të kaluarën, duke i kyçur shembujt për eksperimente, dëshmitë dhe të menduarit kreativ.

#### Planifikon punim hulumtues

- Zgjedh ide dhe bën plane detale për kontrollim të bazuara në dijeninë, kuptimin dhe hulumtimin e mëparshëm .
- Propozon dhe përdor punë preliminare që të vendosë si ta kryejë hulumtimin
  - Vendos vallë a të përdorë fakte të rendit të parë ose burime sekondare.
  - Vendos se cilat matje dhe vëzhgime janë të nevojshme dhe cilat pajisje duhet të përdoren.
  - Vendos se cila pajisje duhet përdorur dhe i vlerëson rrisqet dhe rreziqet në laboratorin ose hapësirën punuese.

### **I gjen dhe i parashtron faktet**

- Bën numër të caktuar vëzhgimesh dhe matjesh që të zvogëlohet gabimi dhe rezultatet të jenë më të besueshme.
- Bën numër të caktuar vëzhgimesh dhe matjesh që të zvogëlohet gabimi dhe rezultatet të jenë më të besueshme
- Kryen vëzhgime dhe matje.
  - Zgjedh mënyrën më të mirë që ti paraqesë rezultatet.

### **Shqyrton dëshmitë dhe qasjet**

- I përshkruan prirjet dhe shabllonet(korrelacionet) që paraqiten tek rezultatet.
- Interpreton rezultatet me ndihmë të dijenisë dhe të kuptuarit shkencorë.
- Ka qëndrim kritik ndaj burimeve dytësore të të dhënave.
- Jep përfundime.
- I vlerëson metodat e përdorura dhe i përmirëson për hulumtimet e mëtuftjeshme.
- I krahason rezultatet dhe metodat e përdorura nga të tjerat.
- Parashtron përfundimet dhe vlerësimet e metodave punuese në mënyra të ndryshme.
- I shpjegon rezultatet duke e përdorur dijeninë dhe të kuptuarit shkencorë. Në mënyrë të qartë i ndan me të tjerët.

## Kimia

### Vetitë e materjes

- I përshkrua metodat dhe zbulimet e Raderfordit.
- E përshkruan strukturën e atomit, duke e kyçur numrin atomik, numrin e masës, shtresat elektronike dhe elektronet valentore.
- E krahason strukturën e atomeve të njëzet elementeve të parë duke e përdorur tabelën e sistemit periodik të elementeve.
- E përshkruan strukturën e sistemit periodik të elementeve dhe trendët në grupet dhe periodat.
- E përshkruan mënyrën e Mendeleevit në radhitjen e elementeve.

### Ndryshime të materjes

- Përdor valencën që të shkruan formula dhe komponime kimike.
- Përdor barazime të përbëra prej fjalëve(emërtimet e substancave) dhe barazimet të përbëra nga formulat kimike, gjegjësisht simbole kimike që të përshkruhen reaksionet e zakonshme.
- Barazon ekuacione të thjeshta kimike (me përdorimin e koeficienteve stehiometrik me numër të plotë për maksimum dy reaktantë dhe/ose dy produkte).
- Përshkruan përbërjen e oksideve, acideve, hidroksideve dhe kripërave dhe emërton disa shembuj.
- E paraqet dhe e shpjegon idenë për reaksionet endoterme, duke e kyçur fotosintezën dhe vlimin e vezëve, dhe reaksione egzoterme, duke e përfshirë djegien..
- E hulumton dhe e përshkruan reaktivitetin e metaleve me oksigjen, ujë dhe acide të holluara.
- Hulumton dhe shpjegon reaksionet e zëvendësimit duke e kyçur edhe vargun e reaktivitetit të metaleve.
- Shpjegon se si të fitohen disa kripëra të zakonshme duke i përfshirë reaksionet e ndryshme.
- E përdor teorinë e thërmijave që ta shpjegojë ndikimin e përqendrimit, madhësinë e thërmijave, temperatura dhe katalizatorët e shpejtësisë së reaksioneve.
- E përshkruan formimin e joneve (katjone dhe anjone) me dhënien dhe pranimin e elektroneve nga ana e atomeve të elementeve nga grupi i parë dhe ishtatëmbëdhjetë.

- Bën dallime ndërmjet atomeve dhe joneve.
- E përshkruan formimin e lidhjes jonike ndërmjet joneve me elektrizim të kundërt.
- E përshkruan formimin e lidhjes kovalente (vetëm lidhje njëfishe) si rezultat i formimit të çiftit të përbashkët elektronik.

## 2. Qëllimet konkret, aktivitete dhe mjetet për punë

Kjo pjesë trajton planifikimin e mësimit dhe paraqet plan –mjafti gjatë për realizim të mësimit nga lënda e kimisë për klasë të IX. Qëllimet e të mësuarit në këtë klasë janë të grupuara në tri fusha tematike në gjysmëvjetorin e parë dhe katër fusha tematike në gjysmëvjetorin e dytë. Ato janë të shpërndarë në javë sipas radhitjes së rekomanduar të realizimit të mësimit. Qëllimet e të mësuarit të hulumtimit shkencorë përsëriten tek njësitë mësimore.

Udhëzimi është i përshtatur me kohëzgjatjen e vitit shkollorë. Gjatë vitit janë parashikuar edhe ditë për vlerësimin e dijenisë, të cilat mund të përdoren për përsëritje në këto fusha që nxënësit kanë nevojë për më shumë ndihmë.

Aktivitete dhe resurset që sugjerohen në përputhje me qëllimet e mësimit i ilustrojnë metodat e mundshme për mësim dhe mbajtjen e mësimit. Aktivitetet e parapara janë të parashikuara si propozime nga të cilat këto mund ti zgjidhni në pajtim me nevojat e nxënësve tuaj. Mund të vendosni të përdorni aktivitete të ndryshme dhe/ose ti plotësoni aktivitete të dhëna me aktivitete tjera për mësim (për shemb. nga librat).

Qendra ndërkombëtare për programet mësimore Kembrixh Interneshenel Egzaminejshens (Cambridge International Examinations) përgjegjës për përmbajtjen e materialeve ose veb-faqet të rekomanduara në këtë dokument. Të gjitha udhëzimet e veb-faqeve në kohën kur është shkruar ky dokument. Duke e marrë parasysh atë se veb-faqet mund të ndryshohen dhe duke e marrë parasysh se përpunohen plane dhe veb-faqet më të mira, arsimtarëve u rekomandojmë ti kontrollojnë veb-faqet para se ti përdorin dhe i inkurajojmë në mënyrë aktive të kërkojnë resurse të reja përkatëse në Internet..

### Shqyrtim

GJYSMËVJETORI I PARË	GJYSMËVJETORI I DYTË
Tema 1A 9.1 Struktura e atomit dhe sistemi periodik i elementeve	Tema 2A 9.4 Formimi i lidhjes jonike dhe barazimi i ekuacioneve kimike
Tema 1B 9.2 Valenca dhe formulat	Tema 2B 9.5 Vargu i reaktivitetit të metaleve
Tema 1C 9.3 Shpejtësia e reaksioneve	Tema 2C 9.6 Përfitimi i kripërave
	Tema 2D 9.7 Reaksionet egzoterme dhe endoterme



## Titujt e ligjëratave

GJYSMËVJETORI I PARË					
Java	Ora	Titulli i ligjëratës	Java	Ora	Titulli i ligjëratës
Java 1	Ora 1	Struktura e atomit	Java 9	Ora 1	Formula të komponimeve që përmbajnë metale kalimtare
	Ora 2	Struktura e atomeve të njëzet elementeve të para		Ora 2	Orë për përsëritje të materialit
Java 2	Ora 1	Simbolet kimike të elementeve	Java 10	Ora 1	Njoftimi me shpejtësinë e reaksionit
	Ora 2	Konfiguracioni elektronik		Ora 2	Ndikimi i përqëndrimit
Java 3	Ora 1	Ushtrime për strukturën e atomit	Java 11	Ora 1	Shpjegim për ndikimin e përqëndrimit
	Ora 2	Struktura e sistemit periodik të elementeve		Ora 2	Ndikimi i madhësisë së thërmijave
Java 4	Ora 1	Përsëritje për strukturën e atomit dhe për sistemin periodik të elementeve	Java 12	Ora 1	Shpjegimi për ndikimit e madhësisë së thërmijave
	Ora 2	Trendet në sistemin periodik të elementeve		Ora 2	Ndikimi i temperaturës
Java 5	Ora 1	Historija e sistemit periodik të elementeve	Java 13	Ora 1	Hulumtimi i ndikimit të temperaturës në shpejtësinë e reaksionit
	Ora 2	Orë për përsëritje të materjalit		Ora 2	Orë për përsëritje të materialit
Java 6	Ora 1	Njoftimi me lidhje kovalente	Java 14	Ora 1	Ndikimi i katalizatorit
	Ora 2	Formimi i molekulave kovalente		Ora 2	Enzimet janë katalizatorë biologjik
Java 7	Ora 1	Orë për përsëritje të materialit	Java 15	Ora 1	Konvertorët katalitik
	Ora 2	Shfrytëzimi i valencës për përcaktimin e formulave molekulare		Ora 2	Përsëritje për shpejtësinë e reaksionit
Java 8	Ora 1	Formulat e kompozimeve binare	Java 16	Ora 1	Orë për përsëritje të materialit
	Ora 2	Formulat e kompozimeve që përmbajnë grupe atomike		Ora 2	Orë për përsëritje të materjalit

GJZSMËVJETORI I DYTË					
Java	Ora	Titulli i ligjëratës	Java	Ora	Titulli i ligjëratës
Java 1	Ora 1	Njoftimi me termin jone	Java 11	Ora 1	Përfitimi I kripërave nga metalet dhe acidet (2)
	Ora 2	Atomet dhe jonet		Ora 2	Përfitimi i kripërave nga oksidet metalike (1)
Java 2	Ora 1	Formimi i lidhjes jonike	Java 12	Ora 1	Përfitimi i kripërave nga oksidet metalike (2)
	Ora 2	Ligji për ruajtjen e masës		Ora 2	Përfitimi i kripërave nga karbonatet (1)
Java 3	Ora 1	Ushtrime për barazimin e ekuacioneve kimike	Java 13	Ora 1	Përfitimi i kripërave nga karbonatet (2)
	Ora 2	Shënimi i barazimeve kimike		Ora 2	Orë për përsëritje të materialit
Java 4	Ora 1	Orë për përsëritje të materialit	Java 14	Ora 1	Përfitimi i kripërave nga hidroksidet
	Ora 2	Reagimi i metaleve me oksigjen		Ora 2	Përmbledhja e metodave për përfitimin e kripërave
Java 5	Ora 1	Reagimi i metaleve me ujë	Java 15	Ora 1	Orë për përsëritje të materialit
	Ora 2	Reagimi i metaleve me acide		Ora 2	Ndryshimet e energjisë gjatë reaksioneve kimike
Java 6	Ora 1	Përbërja e kompozimeve	Java 16	Ora 1	Reaksionet egzoterme ose endoderme?
	Ora 2	Përpilimi i vargut të reaktivitetit		Ora 2	Djegia – reaksioni egzoterm
Java 7	Ora 1	Të mbajturit mend të vargut të reaktivitetit	Java 17	Ora 1	Hulumtimi i djegies së lëndëve djegëse
	Ora 2	Orë për përsëritje të materialit		Ora 2	Orë për përsëritje të materialit
Java 8	Ora 1	Hulumtimi i vargut të reaktivitetit	Java 18	Ora 1	Hulumtimi i proceseve endoterme
	Ora 2	Reaksioni i zëvendësimit		Ora 2	Shëndrrimet e fazave endotermike
Java 9	Ora 1	Parashikimi reaksioneve të zëvendësimit	Java 19	Ora 1	Frymëmarrja dhe fotosinteza
	Ora 2	Vargu i reaktivitetit dhe metodat e ekstraksionit		Ora 2	Përdorimi i proceseve egzoterme dhe endoderme
Java 10	Ora 1	Orë për përsëritje të materialit	Java 20	Ora 1	Orë për përsëritje të materialit
	Ora 2	Përfitimi i kripërave nga metalet dhe acide (1)		Ora 2	Orë për përsëritje të materialit

## Qëllimet e të mësuarit të hulumtimit shkencorë

Kjo është lista e qëllimeve të të mësuarit të hulumtimit shkencorë për këtë klasë. Ato janë të thelluara në themelet e këtij programi mësimorë.

### Idetë dhe dëshmitë

Diskuton dhe shpjegon rëndësinë e pyetjeve, dëshmitë dhe shpjegimet, duke shfrytëzuar shembuj historik dhe bashkëkohorë.

I verifikon shpjegimet duke i përdorur ato në parashtrimin e parakushteve, e mandej i evaluon në raport të dëshmimeve.

Diskuton në mënyrën në të cilën sot shkencëtarët punojnë dhe si kanë punuar në të kaluarën, duke i kyçur shembujt për eksperimente, dëshmitë dhe të menduarit kreativ.

### Planifikon punim hulumtues

Zgjedh ide dhe bën plane detale për kontrollim të bazuara në dijeninë, kuptimin dhe hulumtimin e mëparshëm .

Propozon dhe përdor punë preliminare që të vendosë si ta kryejë hulumtimin.

Vendos vallë a të përdorë fakte të rendit të parë ose burime sekondare.

Vendos se cilat matje dhe vëzhgime janë të nevojshme dhe cilat pajisje duhet të përdoren.

Vendos se cila pajisje duhet përdorur dhe i vlerëson rrisqet dhe rreziqet në laboratorin ose hapësirën punuese.

### I gjen dhe i parashtron faktet

Bën numër të caktuar vëzhgimesh dhe matjesh që të zvogëlohet gabimi dhe rezultatet të jenë më të besueshme.

Përdor materiale dhe pajisje të ndryshme dhe merr masa për mbrojtje.

Kryen vëzhgime dhe matje.

Zgjedh mënyrën më të mirë që ti paraqesë rezultatet.

### Shqyrton dëshmitë dhe qasjet

I përshkruan prirjet dhe shabllonet(korrelacionet) që paraqiten tek rezultatet.

Interpreton rezultatet me ndihmë të dijenisë dhe të kuptuarit shkencorë.

Ka qëndrim kritik ndaj burimeve dytësore të të dhënave.

Jep përfundime.

I vlerëson metodat e përdorura dhe i përmirëson për hulumtimet e mëtutjeshme.

I krahason rezultatet dhe metodat e përdorura nga të tjerat.

Parashtron përfundimet dhe vlerësimet e metodave punuese në mënyra të ndryshme.

I shpjegon rezultatet duke e përdorur dijeninë dhe të kuptuarit shkencorë. Në mënyrë të qartë i ndan me të tjerët.

## Tabela e sistemit periodik të elementeve

Grupi																		
1	2											13	14	15	16	17	18	
												1 H Hidrogjeni 1						2 He Helium 4
3 Li Litium 7	4 Be Berilium 9	numri atomik simboli emri i elementit masa relative atomike										5 B Bor 11	6 C Karbon 12	7 N Azot 14	8 O Oksigjen 16	9 F Fluor 19	10 Ne Neon 20	
11 Na Natrium 23	12 Mg Magnezium 24	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13 Al Aluminium 27	14 Si Силициум 28	15 P Fosfor 31	16 S Sulfur 32	17 Cl Klor 35.5	18 Ar Argon 40	
19 K Kalium 39	20 Ca Kalcium 40	21 Sc Skandium 45	22 Ti Titan 48	23 V Vanadium 51	24 Cr Krom 52	25 Mn Mangan 55	26 Fe Hekur 56	27 Co Kobalt 59	28 Ni Nikel 59	29 Cu Bakër 64	30 Zn Zink 65	31 Ga Galium 70	32 Ge Germanium 73	33 As Arsen 75	34 Se Selen 79	35 Br Brom 80	36 Kr Kripton 84	
37 Rb Pubidium 85	38 Sr Stroncium 88	39 Y Itrium 89	40 Zr Cirkonium 91	41 Nb Niobium 93	42 Mo Molibden 96	43 Tc Tehneций -	44 Ru Rutenium 101	45 Rh Rodium 103	46 Pd Paladium 106	47 Ag Argjend 108	48 Cd Kadmium 112	49 In Indium 115	50 Sn Kallaj 119	51 Sb Antimon 122	52 Te Telur 128	53 I Jod 127	54 Xe Ksenon 131	
55 Cs Cezium 133	56 Ba Barium 137	57-71 Lantanoide	72 Hf Hafnium 178	73 Ta Tantal 181	74 W Volfram 184	75 Re Renium 186	76 Os Osmium 190	77 Ir Iridium 192	78 Pt Platina 195	79 Au Ari 197	80 Hg Zhiva 201	81 Tl Taliun 204	82 Pb Plumbi 207	83 Bi Bizmut 209	84 Po Polonium -	85 At Astat -	86 Rn Radon -	
87 Fr Francium -	88 Ra Radium -	89-103 Aktinoide	104 Rf Raderfordium -	105 Db Dubnium -	106 Sg Siborgium -	107 Bh Borium -	108 Hs Hassium -	109 Mt Majtnerium -	110 Ds Darmshtatium -	111 Rg Rendgenium -	112 Cn Kopernicium -		114 Fl Flerovium -		116 Lv Livermorium -			

Lantanoide	57 La Lantan 139	58 Ce Cerium 140	59 Pr Prazeadimium 141	60 Nd Neodimium 144	61 Pm Prometium 147	62 Sm Samarium 150	63 Eu Europium 152	64 Gd Gadolinium 157	65 Tb Terbium 159	66 Dy Disprozium 163	67 Ho Holmium 165	68 Er Erbium 167	69 Tm Tulium 169	70 Yb Irbium 173	71 Lu Lutecium 175
Aktinoide	89 Ac Aktinium -	90 Th Torium 232	91 Pa Protaktinium 231	92 U Uranium 238	93 Np Neptunium -	94 Pu Plutonium -	95 Am Americium -	96 Cm Kirium -	97 Bk Berklium -	98 Cf Kalifornium -	99 Es Ajnshtajniun -	100 Fm Fermium -	101 Md Mendelevium -	102 No Nobelium -	103 Lr Lorencium -

# GJYSMËVJETORI I PARË

## Tema 1A: 9.1 Struktura e atomit dhe sistemi periodik i elementeve

Kjo tërësi tematike lidhet me atë çka nxënësit më parë e kanë mësuar për modelin e thjeshtë të ndërtimit të atomit, sistemin periodik të elementeve dhe ideja për lidhje kimike.

Tani nxënësit e zhvillojnë dijeninë e tyre me përdorimin e modelit më të përbërë për atomin që përfshin shtresat elektronike. E identifikojnë strukturën elektronike të njëzet elementeve të parë dhe e lidhin këtë me strukturën e tyre në tabelën e sistemit periodik të elementeve dhe mësojnë për formimin e lidhjes kovalente me krijimin e çiftit të përbashkët elektronik.

### Hulumtimi shkencorë përqendrohet në :

Diskutim dhe shpjegim të rëndësisë së pyetjeve, dëshmive, duke përdorur shembuj historik dhe bashkëkohorë;

I verifikon shpjegimet duke i përdorur ato në parashtrimin e parakushteve, e mandej i evaluon në raport të dëshmive.

Diskuton në mënyrën në të cilën sot shkencëtarët punojnë dhe si kanë punuar në të kaluarën, duke i kyçur shembujt për eksperimente, dëshmitë dhe të menduarit kreati

Qëndrim kritik të burimeve sekondare të të dhënave

### Terme të rekomanduara për këtë temë

element  
atom  
proton  
neutron  
elektron  
bërthamë  
simbol  
shtresa elektronike  
numër atomik  
numër i masës  
sistem periodik  
grup  
periodë  
veti  
gazra fisnike  
metale alkaline  
elemente halogjenë  
metale kalimtare  
elektrone valentore  
konfiguracioni elektronik

çift i përbashkët elektronik  
lidhje kimike  
lidhje kovalente  
jometal  
komponim  
eksperiment  
orbitë  
metodë  
diagram me pika dhe hiksa  
formulë strukturale

#### **Hulumtim shkencorë**

përshkruan  
diskuton  
krahason  
përfundon  
prezenton  
supozon  
shpjegon

Qëllimet e mësimit	Aktivitete të propozuara (sipas zgjedhjes)	Resurset	Terminologjia
<b>Java 1</b>			
<p><u>Java 1</u></p> <p>I përshkruan metodat dhe zbulimet e Raderfordit.</p> <p>Diskuton dhe shpjegon rëndësinë e pyetjeve, dëshmiave dhe shpjegimeve, duke përdorur shembuj historik dhe bashkëkohorë.</p> <p>Diskuton për mënyrën në të cilën sot shkencëtarët punojnë dhe si kanë punuar në të kaluarën, duke i kyçur shembujt për eksperimentim, dëshmitë dhe të menduarit kreativ.</p> <p>Ka qëndrim kritik ndaj burimeve sekondare të të dhënave.</p>	<p><u>Ora e 1</u> <u>Struktura e atomit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Fillojeni orën me përsëritje të asaj që e kanë mësuar më parë nxënësit për strukturën e atomit në klasën e VIII. Si hyrje e mirë, që të theksohet madhësia e vogël e atomit, mund të përdoret ndonjë animacion me lëvizjen e atomeve të veçanta. Nxënësit vizatojnë dhe i paraqesin diagramet e thjeshta të strukturës atomike. Pyetni <i>Vallë me të vërtetë kështu duket një atom po të ishte e mundshme që ti shohim me sy?</i></li> <li>Pyetni nxënësit çka dinë për elektronet nga ajo që kanë mësuar nga lënda e fizikës. <i>Si këto ide përputhen me modelin e tyre të atomit?</i></li> <li>Nxënësve sigurojuni burime të informacioneve (të shtypura ose material nga Interneti) për hulumtimin e Raderfordit. Ato i hulumtojmë metodat dhe zbulimet e Raderfordit dhe pregadisnin poster ose prezantim.</li> <li>Aktivitet plotësues. Nxënësve më të talentuar sigurojuni burime të informacioneve (të shtypura ose material nga Interneti). Ato le ta hulumtojnë punën e J. J. Tomson dhe J. Çedvik që njoftohen me metodat dhe zbulimet e tyre.</li> <li><b>Përfundoni</b> se modelet bashkëkohore të strukturës së atomit janë fryt i punës së një numri të madh të</li> </ul>	<p>„Një djalë dhe atomi i tij“ <a href="https://www.youtube.com/watch?v=oSCX78-8-q0">https://www.youtube.com/watch?v=oSCX78-8-q0</a></p> <p>Vërejtje: nxënësit shpeshherë kanë paraqitje të gabuara për modelet shkencore në përgjithësi, a më konkretisht për modelet e atomit. Njëra nga këto është se modeli është version i madh i asaj se si atomi në të vërtetë duket.</p> <p>Shpjegoni se modelet e atomit na mundësojnë të vizualizojmë paraqitjen tonë për atomin dhe sjelljen e tij (psh. Vetitë e trupave të ngurtë, lëngjet, dhe gazrat dhe shabllonet e reaksioneve kimike). Shpjegoni se që ti kuptojmë fushat më të përbëra shkencore, na nevojiten modele më të përbëra. Kjo nuk domethënë se modelet më të thjeshta duhet të anashkalohen. Për zhvillimin dhe përsosshmërinë e modeleve shkencore, nevojitet më shumë kreativitet.</p> <p>Burimet e informacioneve për nxënësit. Video kripi i ardhshëm është ilustrim i mirë për eksperimentin e Raderfordit. <a href="https://www.youtube.com/watch?v=Zd6_zVdMgJk">https://www.youtube.com/watch?v=Zd6_zVdMgJk</a></p> <p>Burime të informacioneve për nxënësit.</p>	<p>atom elektron eksperiment orbitë metodë</p> <p>përshkruan diskuton krahason përfundon prezenton</p>



<p><u>Java 1</u></p> <p>E përshkruan strukturën e atomit, duke e përfshirë numrin atomik, numrin e masës, shtresat elektronike dhe elektronet valentore.</p> <p>E krahason strukturën e atomeve të njëzet elementeve të parë duke përdorur tabelë të sistemit periodik.</p> <p>Përshkruan trendët dhe shabllonet (korrelacionet) që paraqiten në rezultatet..</p>	<p>nxënësve.</p> <p><u>Ora e 2</u> <u>Struktura e atomeve të njëzet elementeve të parë</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përsëritni simbolet e njëzet elementeve të parë.</li> <li>• Diskutoni për tre thërmija kryesore nga të cilat është i përbërë atomi – protone, neutrone dhe elektrone – masat e tyre dhe ngarkesat dhe ku ndodhen ato në atomin..</li> <li>• Njoftojeni termin „numër atomik“ si numër i protoneve në atomin e një elementi. Nxënësit e identifikojnë numrin e masës së njëzet elementeve të parë me ndihmën e tabelës së sistemit periodik të elementeve. <i>Vallë në rezultatet tuaja vërehet ndonjë shabllon ose trend? Deri në çfarë përfundimi mund të arrini nga radhitja e elementeve në sistemin periodik?</i></li> <li>• Njoftoni me termin „numër i masës“ si shumë e numrit të protoneve dhe neutroneve në atomin e një elementi. Parashtroni më shumë pyetje nëpërmjet të cilës nxënësit do të mund të ushtrojnë përcaktimin e numrit atomik, numrin e masës, numrin e protoneve ose numrin e neutroneve nga informacionet të dhëna relevante.</li> <li>• Shpjegoni se atomet janë elektroneutrale. Sipas kësaj, në një atom numri i elektroneve është i barabartë me numrin e protoneve. Nxënësit formulojnë dhe parashtrojnë pyetje që ndërmjet veti ta kontrollojnë dijeninë për numrin atomik, numrin e masës dhe përcaktimin e numrit të protoneve, neutroneve dhe elektroneve në një atom.</li> </ul>	<p>Aplikacion Sistem periodik i Shoqatës Mbretërore Britanike të Kimistëve mund të mirret pa pagesë, dhe atë për Android, si dhe për IOS. (<a href="http://www.rsc.org/periodic-table">http://www.rsc.org/periodic-table</a>)</p> <p>Pyetje për nxënësit.</p>	<p>atom proton neutron elektron bërthamë eksperiment orbitë metodë simbol shtresa elektronike numër atomik numër i masës</p> <p>përshkruan diskuton krahason përfundon prezenton</p>
---	--	---	--

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përfundoni</b> se atomi përbëhet nga bërthama e cila përmban protone dhe neutrone e cila është e rrethuar me elektrone.</li> </ul>		
<b>Java 2</b>			
<p><u>Java 2</u></p> <p>E përshkruan strukturën e atomit, duke e përfshirë numrin atomik, numrin e masës, shtresat elektronike dhe elektronet valentore.</p> <p>E krahason strukturën e atomeve të njëzet elementeve të parë duke përdorur tabelë të sistemit periodik.</p> <p>.</p>	<p><u>Çac 1</u></p> <p><u>Simbolet kimike të elementeve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Fillojeni orën me kontrollimin e asaj se sa kanë kuptuar nxënësit për strukturën themelore të atomit nëpërmjet të kuizit të shpejtë.</li> <li>• Shpjegoni simbolet që përdoren që ta tregojnë numrin e masës dhe numrin atomik të atomeve, për shemb. <math>^{12}_6\text{C}</math>.</li> <li>• Nxënësit e ushtrojnë identifikimin e numrit të protoneve, elektroneve dhe neutroneve kur janë të dhëna simbolet kimike të elementeve të ndryshëm..</li> <li>• Nxënësit ushtrojnë shënimin e simboleve kimike të elementeve, numër të dhënë të protoneve, neutroneve dhe elektroneve.</li> <li>• Bëni lidhshmëri të simboleve kimike me tabelën e sistemit periodik të elementeve. Nxënësit ushtrojnë përcaktimin e elementit kur është i dhënë numri i protoneve.</li> <li>• <b>Përfundoni</b> se simbolet kimike përdoren për paraqitjen e numrit të protoneve, neutroneve dhe elektroneve në atomin e një elementi</li> </ul>	<p>Kuiz pyetje.</p> <p>Pyetje për nxënësit lidhur me simbolet kimike të elementeve.</p>	<p>element proton neutron elektron bërthamë simbol numër atomik numri i masës</p> <p>përshkruan diskuton krahason shpjegon</p>
<p><u>Java 2</u></p> <p>E përshkruan strukturën e atomit, duke e përfshirë numrin atomik, numrin e masës, shtresat elektronike</p>	<p><u>Ora e 2</u></p> <p><u>Konfiguracioni elektronik</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Radhitni njëzet elementet e parë sipas numrave atomik në tabelën thjeshtë të sistemit periodik të elementeve.</li> </ul>	<p>Tabela të shprazta të sistemit periodik të elementeve, komplet karta me njëzet elementet e parë(duke i përfshirë edhe numrat</p>	<p>atom proton neutron elektron bërthamë</p>

<p>dhe elektronet valentore.</p> <p>E krahason strukturën e atomeve të njëzet elementeve të parë duke përdorur tabelë të sistemit periodik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mund të organizohet edhe lojë me letra. Në çdo letër le të ketë simbol, dhe ashtu siç hiqen letrat nga grumbulli, vendosen në vendin e duhur të shprazët në tabelën.</li> <li>Ai që i pari e mbush tabelën e vetë do të jetë fitues.</li> <li>Shqyrtoni strukturën e thjeshtë të atomit. <i>Ku ndodhen elektronet?</i></li> <li>Njoftoni me idenë për shtresat elektronike. Shpjegoni se si shtresat mbushen (për shembull, tek atomi i hidrogjenit, heliumit dhe litiumit). Nxënësit i shënojnë shembujt në fletoren e tyre.</li> <li>Përshkruheni strukturën elektronike të njëzet elementeve të parë. Shpjegoni se në shtresën e parë mund të gjinden maksimum dy elektrone, a në dy të shtresat e ardhshme maksimum nga tetë elektrone. Nxënësit mund të ushtrojnë me vizatimin e disa shembujve të elementeve (për shemb. oksigjen, aluminium dhe kalcium).</li> <li>Përdorni on-line aktivitete për nxënësit që të mundet ta përforcojnë kuptimin e tyre për strukturën e atomit.</li> <li><b>Përfundoni</b> se elektronet në atomin ndodhen në shtresa. Në shtresën e parë mund të ndodhin më së shumti dy elektrone, ndërsa në dy shtresat e ardhshme më së shumti nga tetë elektrone.</li> </ul>	<p>atomik) .</p> <p><a href="http://www.kscience.co.uk/animations/atom.htm">http://www.kscience.co.uk/animations/atom.htm</a></p> <p><a href="http://www.freezeray.com/flashFiles/atomBuilder.htm">http://www.freezeray.com/flashFiles/atomBuilder.htm</a></p>	<p>eksperiment orbitë metodë simbol shtresa elektronike numër atomik numër i masës</p> <p>përshkruan diskuton krahason përfundon prezanton</p>
<b>Java 3</b>			
<p><u>Java 3</u></p> <p>E përshkruan strukturën e atomit, duke e përfshirë numrin atomik, numrin e masës, shtresat elektronike</p>	<p><u>Ora e 1</u> <u>Ushtrime për strukturën e atomit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kontrolloni vallë nxënësit kujtohen si përdoreshe tabela e sistemit periodik të elementeve për përcaktimin e numrit të elektroneve në një atom dhe</li> </ul>	<p>Tabela e sistemit periodik të elementeve</p>	<p>element atom proton neutron elektron</p>

<p>dhe elektronet valentore.</p> <p>E krahason strukturën e atomeve të njëzet elementeve të parë duke përdorur tabelë të sistemit periodik.</p> <p>Përshkruan trendët dhe shabllonet (korrelacionet) që paraqiten në rezultatet</p>	<p>parimin për vizatimin e shtresave elektronike për njëzet elementet e parë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorimi i on-line aktiviteteve për nxënësit që ta përforcojnë kuptimin për radhitjen e elektroneve në shtresat tek njëzet elementet e parë.</li> <li>• Nxënësit vizatojnë dijagramë të atomeve për njëzet elementet të parë, ku e paraqesin strukturën e tyre dhe radhitjen e elektroneve në shtresa.</li> <li>• CMe ndihmën e diagrameve të tyre dhe me ndihmën e tabelës së sistemit periodik të elementeve, nxënësit identifikojnë shabllone. Shpjegoni termin „grup“ si kolonë vertikale, a termi „periodë“ si rend/varg horizontal.</li> </ul> <p><i>Çka kanë të përbashkët elementet e grupit të parë? E çka kanë në grupin e dytë? Çka kanë të përbashkët elementet e periodës së parë? E çka kanë në periodën e dytë?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit shkruajnë rezyme në të cilën e përshkruajnë lidhshmërinë ndërmjet strukturës së atomit dhe tabelën e sistemit periodik të elementeve. Kjo duhet të kyç informacione për : <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numrin atomik;</li> <li>• Numrin e shtresave me elektrone;</li> <li>• Numri i elektroneve në shtresën e fundit.</li> </ul> </li> <li>• <b>Përfundoni</b> se struktura e atomit është e lidhur me informacionet të dhëna në tabelën e sistemit periodik të elementeve.</li> </ul>	<p>Elektronet në njëzet elementeve të parë  <a href="http://www.absorblearning.com/chemistry/dem o/units/fullscreen.html?src=media/LR302302d.swf&amp;title=undefined&amp;w=350&amp;h=180">http://www.absorblearning.com/chemistry/dem o/units/fullscreen.html?src=media/LR302302d.swf&amp;title=undefined&amp;w=350&amp;h=180</a></p> <p>Tabela e sistemit periodik të elementeve</p>	<p>bërthamë simbol shtresa elektronike grup periodë numër atomik numër i masës konfiguracion elektronik</p> <p>përshkruan diskuton krahason përfundon prezanton</p>
<p><u>Java 3</u></p> <p>.</p> <p>E përshkruan strukturën e</p>	<p><u>Ora e 2</u>  <u>Struktura e sistemit periodik të elementeve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përcaktoni çdo nxënësi nga një element(nga njëzet</li> </ul>		<p>element atom proton</p>

<p>sistemit periodik të elementeve dhe trendët e grupeve dhe periodave.</p>	<p>elementet e para). Në çifte, çdonjëri nga nxënësit e nxënësit fqinj që rrinë afër tij e përshkruan vendin në sistemin periodik të elementit që i është dhënë. Ato duhet të tregojnë se dinë ti përdorin termet: grupe,perioda, shtresa elektronike, numër i elektroneve në shtresën e fundit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Njoftoni me termin elektrone valentore dhe shpjegoni si elektrone që mund të përdoren për formimin e lidhjeve kimike. Kërkoni nga nxënësit që ta identifikojnë numrin e elektroneve valentore në grupe të ndryshme (vetëm për njëzet elemente të parë).</li> <li>Nxënësit ushtrojnë verifikimin e lidhshmërisë së strukturës së atomit me numrin e periodës dhe të grupit dhe e kundërta.</li> <li>Jepni nxënësve kopje nga tabela e sistemit periodik të elementeve. Ato i shënojnë vërejtjet ose e ngjyrosin me qëllim të identifikimit të vetive të elementeve, për shemb. metale dhe jometal ose substanca të ngurta, lëngjet dhe gazra (në temperaturë të dhomës).</li> <li><b>Përfundoni</b> se informacionet të dhëna në tabelën e sistemit periodik të elementeve mund të përdoren për formimin e strukturës së atomit. Dhe e kundërta, struktura e atomit mund të përdoret për përcaktimin e vendit të tyre në sistemin periodik.</li> </ul>	<p>Tabelë e sistemit periodik të elementeve. Ka disa simulacione dhe veb-lokacione interaktive që mund të jenë të përdorshme për këtë temë.</p> <p><a href="http://www.ptable.com/http://www.syngentaperiodictable.co.uk/periodic-table.php?keyStage=5&amp;showState=g">http://www.ptable.com/http://www.syngentaperiodictable.co.uk/periodic-table.php?keyStage=5&amp;showState=g</a></p> <p><a href="http://www.learner.org/interactives/periodic/periodic_table.html">http://www.learner.org/interactives/periodic/periodic_table.html</a></p> <p>Vërejtje: në këtë fazë duhet nxënësit ta dinë konfiguracionin elektronik sipas orbitaleve.</p>	<p>neutron elektron bërthamë simbol shtresa elektronike numër atomik numër i masës konfiguracion elektronik sistemi periodik grupi perioda elektrone valentore</p> <p>përshkruan diskuton krahason përfundon prezanton</p>
<b>Java 4</b>			
<p><u>Java 4</u></p>	<p><u>Ora e 1</u> <u>Përsëritje për strukturën e atomit dhe për sistemin periodik</u></p>		

<p>E përshkruan strukturën e atomit, duke e përfshirë numrin atomik, numrin e masës, shtresat elektronike dhe elektronet valentore.</p> <p>E krahason strukturën e atomeve të njëzet elementeve të parë duke përdorur tabelë të sistemit periodik.</p>	<p><u>të elementeve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregojuni nxënësve foto nga struktura e atomit prej njëzet elementeve të parë. Vëzhgoni vallë nxënësit mund ti identifikojnë:</li> <li>• Numrin atomik dhe numrin e masës;</li> <li>• Numri i protoneve, neutroneve dhe elektroneve;</li> <li>• Numri i shtresave elektronike;</li> <li>• Numri i elektroneve valentore;</li> <li>• Numri i grupit, numri i periodës dhe emri i elementit.</li> </ul> <p>Nxënësit e vërtetojnë dijeninë e tyre për strukturën e atomit në atë mënyrë që përpunojnë model tridimensional të atomit në të cilin qartë është e paraqitur radhitja e elektroneve në shtresat. (Çdo nxënësi/grupit nxënësve jepni element të ndryshëm). Përdorni modelet tridimensionale që të bëni ekspozitë në klasë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit përdorin simulime elektronike për përpilim dhe krahasim të atomeve.</li> <li>• <b>Përfundoni</b> se sistemi periodik jep një numër të madh informacionesh për atomet e çdo elementi.</li> </ul>	<p>Foto.</p> <p>Materialet që mund të përdoren për përpunimin e strukturave tridimensionale të elementeve për shemb. ballonë, plastelinë, zhetonë, monistë, topta pambuku, shkurë mashmellou etj.</p> <p>Simulacioni „Përpuno atom“  <a href="http://phet.colorado.edu/mk/simulation/legacy/build-an-atom">http://phet.colorado.edu/mk/simulation/legacy/build-an-atom</a>  (Simulacioni është në dispozicion në gjuhën maqedonase, shqipe, serbe dhe turke).</p>	<p>element atom proton neutron elektron bërthamë simbol shtresa elektronike numër atomik numër i masës konfiguracion elektronik sistemi periodik grupi perioda elektrone valentore</p> <p>përshkruan diskuton prezanton</p>
<p><u>Java4</u></p> <p>E përshkruan strukturën e sistemit periodik të elementeve dhe trendët e grupeve dhe periodave.</p> <p>I kontrollon shpjegimet me përdorimin e tyre në parashtrimin e supozimeve, e mandej i</p>	<p><u>Ora e 2</u> <u>Trendet në sistemin periodik të elementeve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në fillim të orës kërkoni nga nxënësit të identifikojnë elemente sipas numrit të shtresave dhe sipas numrit të elektroneve valentore (për shemb. <i>Cili element ka 2 shtresa dhe 4 elektrone valentore?</i>).</li> <li>• Njoftoni emrat specifik të elementeve në grupet e ndryshme, p.sh gazrat fisnike, metalet alkaline, elemente halogjenë, metale kalimtare.</li> <li>• Shqyrtoni disa grupe elementesh dhe gjeni</li> </ul>	<p>Letër punuese për identifikimin e elementeve.</p>	<p>element atom proton neutron elektron bërthamë simbol shtresa elektronike numër atomik numër i masës sistemi periodik</p>

<p>vlerëson në raport të dëshmimeve.</p> <p>Ka qëndrim kritik ndaj burimeve sekondare të të dhënave.</p> <p>Përshkruan trendët dhe shabllonet (korrelacionet) që paraqiten në rezultatet.</p>	<p>ngjashmëri në suazat e grupit ( për shemb. grupet 1,17 dhe 18). Nxënësit mund të japin supozime për atë se cila elemente e ndjekin grupin. Mandej mund të përdorin burime sekondare për krahasimin e supozimeve të veta me vetitë faktike të elementit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryeni krahasimin e reaktivitetit dhe të vetive ndërmjet elementeve që janë njëri ndër tjetrin në suazat grupit të njëjtë, për shemb.:</li> <li>• Reaksionet e litiumit dhe natriumit me ujë;</li> <li>• Reaksionet e magneziumit dhe kalciumit me acid të holluar ;</li> </ul> <p>Vetitë fizike të klorit, bromit dhe jodit.</p> <p>Nxënësit bëjnë supozime të mëtutjeshme për elemente të tjera në suazat e grupeve që i kanë mësuar në orë dhe kryejnë kontrollimin e supozimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përfundoni</b> se vetitë kimike të elementeve nga grupi i njëjtë janë të ngjashëm. Tek vetitë fizike të elementeve të grupit të njëjtë vërehet trend.</li> </ul>	<p>Burimet sekondare për vetitë e elementeve.  <a href="http://www.ptable.com/http://www.syngentaperiodictable.co.uk/periodic-table.php?keyStage=5&amp;showState=g">http://www.ptable.com/http://www.syngentaperiodictable.co.uk/periodic-table.php?keyStage=5&amp;showState=g</a>  <a href="http://www.learner.org/interactives/periodic/periodic_table.html">http://www.learner.org/interactives/periodic/periodic_table.html</a></p> <p>Vërejtje : në këtë fazë nuk duhet nxënësit ta dinë konfiguracionin elektronik sipas orbitaleve.</p> <p>Reaksioni litiumit me ujë  <a href="https://youtu.be/tAr6Lbb_qvQ">https://youtu.be/tAr6Lbb_qvQ</a>  Reaksioni i natriumit me ujë  <a href="https://youtu.be/9bAhCHedVB4">https://youtu.be/9bAhCHedVB4</a>  Reaksioni i kaliumit me ujë  <a href="https://youtu.be/rtNaEFXOdAc">https://youtu.be/rtNaEFXOdAc</a>  Magneziumi dhe kaliumi me acidin klorhidrik  <a href="https://youtu.be/tn2MHD_9DeM">https://youtu.be/tn2MHD_9DeM</a>  Grafikon me temperaturat e shkrirjes dhe të vlimit të elementeve halogjenë.  <a href="http://www.bbc.co.uk/schools/gcsebitesize/science/add_ocr_pre_2011/periodic_table/group7rev1.shtml">http://www.bbc.co.uk/schools/gcsebitesize/science/add_ocr_pre_2011/periodic_table/group7rev1.shtml</a></p>	<p>grupi perioda  vetitë gazra fisnike  metale alkaline  elemente halogjenë  metale kalimtare</p> <p>përshkruan diskuton krahason përfundon prezanton supozon</p>
---	---	---	---

## Java 5

<p><u>Java 5</u></p> <p>E përshkruan paraqitjen e Mendeleevit për radhitjen e elementeve.</p> <p>E diskuton dhe e shpjegon rëndësinë e pyetjeve, dëshmimeve dhe shpjegimeve, duke përdorur shembuj historik dhe bashkëkohorë.</p>	<p><u>Ora e 1</u>  <u>Historia e sistemit periodik të elementeve</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtron të a.sh.q . „aktivitetin e pazarit“ për historinë e sistemit periodik.</li> <li>• Ndani nxënësit në grupe dhe jepni atyre emrin e shkencëtarit që e ka studiuar sistemin periodik për të cilin do të duhet ta hulumtojnë. Shkencëtarët e rëndësishëm që mund të hulumtojnë janë:  Johan Wolfgang Deberajner (dhe triadat e tyre)  Xhon Njulends (dhe oktetet e tyre)  Dimitrij Mendelejev</li> </ul>		<p>element  atom  proton  neutron  elektron  bërthamë  simbol  shtresa elektronike  numër atomik  numër i masës  sistemi periodik</p>
---	--	--	---

<p>Diskuton për mënyrën në të cilën sot shkencëtarët punojnë dhe si ato kanë punuar në të kaluarën, duke i përfshirë shembujt për eksperimentim, dëshmi dhe të menduarit kreativ.</p> <p>Ka qëndrim kritik ndaj burimet sekondare të të dhënave.</p>	<p>Henri Mozli .</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Çdo grupi jepni informacione për shkencëtarin e tyre (për shemb. letra punuese, veb-faqet ose librat). Nxënësit i përdorin informacionet që të përpunojnë poster. Posterit duhet të përfshijë vizatime dhe më së paku 10 fjalë kyçe.</li> <li>Merrni mbresa burimet e informacioneve origjinale.</li> </ul> <p>Njëri nga nxënësit në grupo të mbetet tek posterit („tezgaxhi“) përderisa të tjerët („hulumtues“) i vizitojnë „tezgat“ të tjera dhe mbledhin informacione. „Tezgaxhija“ duhet të tjerëve t’ua shpjegojë temën , dhe mandej ta përdorë vetëm posterin.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>„Hulumtuesit“ kthehen në grupin e tyre dhe i ndajnë informacionet e tyre me „tezgaxhinë“.</li> <li>Të gjithë nxënësit duhet të përpunojnë një punim me kohëzgjatje të caktuar në të cilën do të jenë të rezimuara ndodhitë kryesore në historinë e sistemit periodik.</li> <li><b>Përfundoni</b> se sistemi periodik aktual i elementeve është fryt i hulumtimit të një numri të madh të shkencëtarëve.</li> </ul>	<p>Burimet informative të mundshme për nxënësit (në gjuhën angleze).</p> <p><a href="http://www.bbc.co.uk/education/guides/zfn9q6f/revision/1">http://www.bbc.co.uk/education/guides/zfn9q6f/revision/1</a></p> <p><a href="http://www.rsc.org/periodic-table/history/about">http://www.rsc.org/periodic-table/history/about</a></p> <p><a href="https://www.tes.com/teaching-resource/periodic-table-introduction-6330640">https://www.tes.com/teaching-resource/periodic-table-introduction-6330640</a> (është e domosdoshme pa para të regjistroni)</p> <p>Shembull për kohëzgjatje.</p> <p><a href="https://www.tes.com/teaching-resource/development-of-the-periodic-table-6079255">https://www.tes.com/teaching-resource/development-of-the-periodic-table-6079255</a> (është e domosdoshme pa para të regjistroni)</p>	<p>grupi perioda veti</p> <p>diskuton krahason prezanton</p>
<p><u>Java 5</u></p>	<p><u>Ora e 2</u> <u>Orë për përsëritje të materialit</u></p> <p>Orë për përsëritje të materialit për ndërtimin e atomit dhe për sistemin periodik të elementeve.</p>		
<p><b>Java 6</b></p>			
<p><u>Java 6</u></p>	<p><u>Ora e 1</u> <u>Njoftimi me lidhjet kovalente</u></p>		<p>element</p>



<p>E përshkruan formimin e lidhjes kovalente (vetëm lidhje kovalente) si rezultat i formimit të çiftit të përbashkët elektronik.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Tregojuni nxënësve disa diagrame të elementeve dhe kompozimeve nga klasa e VIII . Përsëritni termet „element“ dhe „komponim“.Le të ketë edhe diagram me element të ndërtuar nga molekula dyatomike, për shemb. hidrogjen. <i>Vallë a është element apo komponim? Nga e dini ? Çka i mban të dy atomet bashkë?</i> Përsëritni atë që e keni mësuar për lidhjet kimike dhe për molekulat nga klasa e VIII.</li> <li>Shpjegoni se lidhja kovalente formohet kur dy atome kanë çift të përbashkët elektronik.</li> <li>Tregoni se si të vizatohet diagram me të cilin do ta paraqesin lidhjen në molekulën e hidrogjenit me përdorimin e diagramit me pika dhe iksa. Nxënësit e vizatojnë diagramin.</li> </ul> <p>Shpjegoni se lidhja kovalente mund të shënohet me lidhje njëfishe. Nxënësit e vizatojnë molekulën e hidrogjenit dhe e paraqesin lidhjen kovalente me një lidhje njëfishe. Nxënësit mund të përkujtohen se më parë kanë shkruar formula strukturale të këtij lloji nga klasa e VIII.</p> <p>Përsëriteni këtë me flori që të tregoni se si vizatohen lidhjet kovalente për atomet e elementeve nga perioda e dytë ose e tretë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Jepni listë me formula të substancave me lidhje kovalente. <i>Çfarë lloje elementesh marrin pjesë në formimin e lidhjes kovalente?</i> Shpjegoni se lidhja kovalente formohet ndërmjet dy atomeve të jometaleve.</li> <li>Nxënësit ushtrojnë vizatimin e shembujve të tjerë të lidhjes kovalente (për shemb. tek klori ). Për të gjithë shembujt, ato vizatojnë diagram me pika dhe iksa</li> </ul>	<p>Dijagrame për pasqyrimin e elementit dhe komponimit.</p> <div data-bbox="1227 657 1496 858" data-label="Chemical-Block"> </div> <p>Lista me formula të substancave me lidhje kovalente.</p>	<p>komponim lidhje kimike elektrone valentore çifti i përbashkët elektronik lidhje kovalente jometal diagram me pika dhe iksa formulë strukturale</p> <p>përshkruan diskuton krahason përfundon prezanton supozon</p>
--	---	--	---

	<p>dhe formula strukturale(ku lidhjet janë të paraqitura me vija).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Tregojuni nxënësve diagrame me pika dhe iksa për substanca të ndryshme me lidhje kovalente. Nxënësit i vizatojnë në formë të formulave strukturale.</li> <li><b>Përfundoni</b> se lidhja kovalente paraqet formimin e çiftit të përbashkët elektronik.</li> </ul>	<p>Shembuj të diagrameve me pika dhe iksa për molekula kovalente me lidhje njëfishe..</p>	
<p><u>Java 6</u></p> <p>E përshkruan formimin e lidhjes kovalente (vetëm lidhje njëfishe) si rezultat i formimit të çiftit të përbashkët elektronik.</p>	<p><u>Ora e 2</u> <u>Formimi i molekulave kovalente</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Në fillim kërkoni nga nxënësit ti shënojnë ose ti vizatojnë konfiguracionet elektronike të atomeve të disa jometaleve (për shemb. hidrogjen, oksigjen, azot, flor, klor). Nxënësit e identifikojnë numrin e elektroneve valentore.</li> <li>Tregoni se si gjehet numri i elektroneve që duhet të jenë të shpërndarë tek flori ose klori. (Shpjegoni se mënyra më e lehtë që të arrihet tek ky numër është që nga numri 8 të minusohet numri i elektroneve valentore, me përjashtim të hidrogjenit.) Tregoni si të shfrytëzohet ky numër që të gjehet numri i lidhjeve kovalente që çdo atom mund ti krijoj.</li> <li>Kërkoni nga nxënësit ta gjejnë numrin e lidhjeve kovalente që atomi i oksigjenit mund ti krijojë dhe që atomi i hidrogjenit mund ta krijojë. Nxënësit diskutojnë në çifte, dhe mandej vizatojnë sipas tyre çka është shpërndarje e elektroneve në molekulën e ujit. Diskutoni për përgjigjet dhe lidheni me formulën molekulare për ujin e cila është H<sub>2</sub>O.</li> <li>Përkujtohuni në strukturën e katër alkanëve të parë nga klasa VIII. Kërkoni nga nxënësit të vizatojnë diagram me pika dhe iksa si dhe formulën strukturale të metanit.</li> </ul>		<p>element atom elektrone valentore konfiguracioni elektronik çifti i përbashkët elektronik lidhje kovalente diagram me pika dhe iksa formulë strukturale</p> <p>përshkruan krahason prezanton</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Jepni nxënësve listë me molekula të zakonshme. Për çdonjërën prej tyre duhet të vizatojnë dijagrame pika dhe iksa në të cilën do të jenë të paraqitura çiftet e përbashkëta elektronike nga lidhja kovalente, si dhe të shkruajnë formula strukturale.</li> </ul> <p>Nëse keni pajisje për modelimin e molekulave nxënësit mund të përpunojnë struktura tridimensionale për çdonjërën prej molekulave. Ose po, mund të shërbehen me plastelinë dhe shkoptha për koktejl.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Aktivitet plotësues. Nxënësve më të talentuar mund t'u tregoni se si ta paraqesin lidhjen dyfishe. Ato mund ta përdorin këtë tek O<sub>2</sub> dhe CO<sub>2</sub>.</li> <li><b>Përfundoni</b> se lidhja kovalente paraqet formimin e çift të përbashkët elektronik ndërmjet dy atome të jometaleve.</li> </ul>	<p>Lista molekulave të shpeshta, për shemb. H<sub>2</sub>, HCl, Cl<sub>2</sub>, H<sub>2</sub>O, NH<sub>3</sub> etj.</p> <p>Pajisje për modelimin e molekulave ose plastelinë dhe shkoptha për koktejl.</p>	
<b>Java 7</b>			
<u>Java 7</u>	<u>Ora e 1</u> <u>Orë për përsëritje të materialit</u>  <u>Orë për përsëritje tematike .</u>		

## Tema 1B: 9.2 Valenca dhe formulat

Kjo tërësi tematike lidhet me atë çka nxënësit më parë kanë mësuar për strukturën e atomit dhe për konfiguracionin elektronik, për strukturën në tabelë të sistemit periodik të elementeve dhe për reaksionet kimike. Tani nxënësit do të mësojnë se si ti shënojnë formulat e komponimeve të ndryshme duke e përdorur valencën.

Hulumtimi shkencorë përqendrohet në :

Kjo tërësi tematike i dedikohet hulumtimeve që nxënësit duhet ta kenë marrë në klasën e VIII . Ajo çka është e përpunuar nën kornizat e kësaj tërësie përdoret për interpretimin e hulumtimeve që nxënësit do ta bëjnë më vonë në klasë të IX.

Fjalë (terme) të rekomanduara në këtë temë:

Valenca, simbol, formulë, atom, komponim, molekulë, rregulla e kryqëzimit, sistem periodik, dyatomike, shpjegon.

Qëllimet e mësimit	Aktivitete(sipas zgjedhjes) të propozuara	Resurset	Terminologjia
<b>Java 7</b>			
<p><u>Java 7</u></p> <p>Përdor valencën që të shkruajë formula të komponimeve kimike.</p>	<p><u>Ora e 2</u> <u>Përdorimi i valencës për përcaktimin e formulave molekulare</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Përkujtohuni në valencën e hidrogjenit dhe karbonit. <i>Sa elektrone valentore kanë? Sa lidhje kovalente çdonjëra prej tyre mund të krijojë? Çka është valenca?</i></li> </ul> <p>Bëni lidhshmërinë e valencës me numrin e lidhjeve kovalente që çdo element mund ta formojë, e cila ishte e përfshirë në tërësinë tematike të mëparshme.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Tregoni se si valenca është e lidhur me vendpozitën e elementeve në sistemin periodik. Kini kujdes që të jenë të kyçura edhe elementet e metaleve, dhe të jometaleve.</li> <li>Shpjegoni si të arrihet deri tek formulat të thjeshta të komponimeve binare me ndihmën e rregullës së kryqëzimit. Shpjegoni përdorimin e indekseve.</li> <li>Nxënësit mund ta përdorin simulacionin „Përpilo molekula“ që nëmësojnë për indekset dhe formulat e kompozimeve të thjeshta.</li> <li>Nxënësit ushtrojnë shënimin e formulave të kompozimeve të ndryshme.</li> <li>Kini kujdes që nxënësit të përkujtohen për elementet që ekzistojnë si molekula dyatomike.</li> </ul>	<p>Sistem periodik.</p> <p>Vërejtje : në këtë fazë nuk është e nevojshme që nxënësit të dinë se çka është lidhje jonike. Për këtë do të mësojnë më vonë gjatë vitit. Për molekula kovalente, zgjidhni shembuj ku formula molekualre është e njëjtë me formulën empirike.</p> <p><a href="http://phet.colorado.edu/mk/simulation/legacy/build-a-molecule">http://phet.colorado.edu/mk/simulation/legacy/build-a-molecule</a> (simulacioni është në dispozicion në gjuhën maqedonase, serbe dhe turke) . Fletë punuese me emrat e komponimeve të thjeshta binare.</p> <p>Vërejtje: informacione për elemente dyatomike mund të përdoren për vërejtje plotësuese në kopjeve nga sistemi periodik i nxënësve.</p>	<p>valenca simbol formulë atom komponim molekulë rregulla e kryqëzimit sistem periodik</p> <p>shpjegon</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përfundoni</b> se valencat dhe rregulla e kryqëzimit mund të përdoret për shënimin e formulave të komponimeve kimike.</li> </ul>		
<b>Java 8</b>			
<u>Java 8</u>  Përdor valencat që ti shënojnë formulat e kompozimeve kimike.	<u>Ora e 1</u> <u>Formulat e komponimeve binare</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Filloni me përsëritje të valencës së elementeve të ndryshëm.</li> <li>• Nxënësit ushtrojnë shënimin e formulave të komponimeve binare. Siguroni disa aktivitete për nxënësit që të mundën ti ushtrojnë këto aftësi. Aktivitete të mundshme janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Gara në grupe ;</li> <li>• Kuize me pyetje me më shumë përgjigje të ofruara;</li> <li>• Radhitja e letrave për lidhjen e emrit me formulë të saktë;</li> <li>• bingo.</li> </ul> </li> </ul> <p>Vlerësoni kuptimin e nxënësve për shënimin e formulave të komponimeve binare me ndihmën e mini-tabelave ose ndonjë mënyrë tjetër për kuiz të shpejtë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përfundoni</b> se valenca dhe rregulla e kryqëzimit mund të përdoret për shënimin e formulave të komponimeve kimike të cilat përmbajnë dy elementet ndryshme.</li> </ul>	Mjetet punuese për këto aktivitete mund të jenë të përpunuara nga grupe nxënësish, të cilët mandej do ti shkëmbejnë që ta provojnë aktivitetin e grupit tjetër. Aktivitetet e mira mund të ruhen që të përsëriten dhe të përdoren sërish vitet e ardhshme.  Mini-tabela, markerë dhe goma.	valenca simbol formulë atom komponim molekulë rregulla e kryqëzimit sistem periodik  shpjegon
<u>Java 8</u>  Përdor valencat që ti shënojnë formulat e kompozimeve kimike.	<u>Ora e 2</u> <u>Formulat e komponimeve që përmbajnë grupe atomike</u> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Në tabelë shënoni disa formula të pasakta të kompozimeve binare dhe kërkoni nga nxënësit ti përmirësojnë gabimet.</li> <li>• Njoftoni me formulat dhe valencën e grupeve atomike (për shemb. sulfate, nitrate, hidrokside, karbonate). Shpjegoni dhe tregoni përdorimin e kllapave tek formulat.</li> </ul>		valenca simbol formulë atom komponim molekulë rregulla e kryqëzimit sistem periodik

	<p>Nxënësit ushtrojnë shënimin e formulave dhe emërimin e varg komponimeve që përmbajnë grup atomik. Kemikatet që ishin të mësuara në klasën e VIII mund të përdoret si shembull.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përfundoni</b> se grupeve atomike mund t'u përcaktohet valenca.</li> </ul>	Letra punuese me emrat ose formulat e komponimeve që përmbajnë grup atomik.	
<b>Java 9</b>			
<p><u>Java 9</u></p> <p>Përdor valencat që ti shënojnë formulat e komponimeve kimike.</p>	<p><u>Ora e 1</u> <u>Formulat e komponimeve që përmbajnë metale kalimtare</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkoni nga nxënësit që ta shënojnë formulën e oksid bakri. <i>Me çfarë problemi ballafaqoheni? Si mund ta përcaktojmë valencën e metaleve kalimtare?</i></li> <li>• Jepni nxënësve lista të valencës të metaleve kalimtare të shpeshta, duke i kyçur edhe ato me valencë të ndryshueshme. Shpjegoni përdorimin e numrave romakë dhe të kllapave në emrat e komponimeve të tyre.</li> </ul> <p>Nxënësit ushtrojnë shënimin e formulave dhe emërimin e varg komponimeve që përmbajnë metale kalimtare. Kemikatet që ishin të mësuara në klasën e VIII mund të përdoret si shembull.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përfundoni</b> se disa metale kanë valencë të ndryshueshme, e cila shënohet me numra romak pas emrit të metalit.</li> </ul>	<p>Vërejtje: Kjo është mundësi e mirë që ti përkujtoni nxënësit për vendin e metaleve kalimtare në tabelën e sistemit periodik të elementeve.</p> <p>Letra punuese me emrat ose formulat e komponimeve që përmbajnë metal kalimtar. Ato, poashtu, mund të kyçin grupe atomike.</p>	<p>valenca simbol formulë atom komponim molekulë rregulla e kryqëzimit sistem periodik dyatomike</p> <p>shpjegon</p>
<p><u>Java 9</u></p>	<p><u>Ora e 2</u> <u>Orë për përsëritje të materialit</u></p> <p>Orë për përsëritje tematike</p>		

## Tema 1C: 9.3 Shpejtësia e reaksioneve

Kjo njësi mësimore lidhet me atë çka nxënësit e mësuuan për reaksionet kimike dhe teorinë për thërmijat e materies.

Nxënësit tani do të mësojnë për ndikimin e përqendrimit, madhësisë së thërmijave, temperaturës dhe të katalizatorëve në shpejtësinë e reaksionit. E përdorin teorinë për thërmijat e materies dhe mësojnë se si ta përdorin që ta shpjegojnë ndikimin e faktorëve të ndryshëm në shpejtësinë e reaksionit.

### Hulumtimi shkencorë përqendrohet në:

- Zgjedhja e ideve dhe kryerja e planeve detale për kontrollimin të bazuar në dijeninë, kuptimin dhe hulumtimin e mëparshëm;
- Parashtrimi dhe përdorimi i punës preliminare që tëvendosë se si ta kryejë hulumtimin;
- Vendosje cilat matje dhe vëzhgime janë të nevojshëm dhe cila pajisje të përdoret;
- Vendos se cila pajisje të përdoret dhe vlerësimi i risqeve dhe rreziqeve në laborator ose hapësirën e punës;
- Kryerja e një numri të madh vëzhgimeve dhe matjet që të zvogëlohet gabimi dhe rezultatet të jenë më bindëse ;
- Përdorimi i materialeve të ndryshme, pajisje dhe përdorimi i masave për kujdes ;
- Kryerja e vëzhgimeve dhe matjeve;
- Zgjedhja e mënyrës më të mirë për paraqitjen e rezultateve;
- Përshkrimi i trendëve dhe shabloneve(korrelacionet) që paraqiten në rezultatet;
- Interpretimi i rezultateve duke përdorur dijeninë dhe të kuptuarit ;
- Qëndrim kritik ndaj burimeve sekondare të të dhënave;
- Nxjerrja e përfundimeve ;
- Krahasimi i rezultateve dhe metodave të përdorura nga të tjerët;
- Shpjegimi i rezultateve duke përdorur dijeninë dhe të kuptuarit shkencorë ;
- Ndarja e qartë me të tjerët.



**Fjalë(terme) të rekomanduara për këtë temë**

Shpejtësi e reaksionit  
Energjia e aktivizimit  
përplasje  
temperatura  
përqendrimi(koncentracioni)  
thërmijë  
madhësia e thërmijës  
sipërfaqe  
katalizator  
përshpejton  
ndikim  
reaktantë  
produkte  
zmadhon/zvogëlon  
ndryshore  
konvertor katalitik

**Научно истражување**  
hulumton  
vëzhgon  
përshkruan  
evidenton  
shpjegon  
hulumton  
pajisje  
mjete  
krahason  
vlerëson  
përfundon  
propozon  
risk  
rrezik  
matje

Qëllimet e mësimit	Aktivitete të propozuara (sipas zgjedhjes)	Resurset	Terminologjia
<b>Java 10</b>			
<p><u>Java 10</u></p> <p>E përdor teorinë e thërmijave që ta shpjegojë ndikimin e përqendrimit, madhësinë e thërmijave, temperatura dhe katalizatorët në shpejtësinë e reaksionit.</p>	<p><u>Ora e 1</u> <u>Njoftimi me shpejtësinë e reaksionit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregoni foto nga reaksione kimike të ndryshme. <i>Vallë për të gjitha reaksione është e nevojshme kohë e njëjtë? Cila reaksione janë më të shpejta? Çka nënkuptojmë nën shpejtësinë e reaksionit?</i></li> <li>• Shpjegoni se shpejtësia e reaksionit është koha e nevojshme që reaktantët të shëndrohen në produkte.</li> <li>• Kërkoni nga nxënësit që ti parashtrojnë disa shembuj për reaksione të ngadalshëm dhe të shpejtë</li> <li>• Shpjegoni se që të ndodh ndonjë reaksion, thërmijat e reaktanteve duhet të përplasen. Disa përplasje do të rezultojnë me reaksion, përderisa të tjerët jo. <i>Çka mund të ndikojë në shpejtësinë e reaksionit?</i></li> <li>• Nxënësit diskutojnë për faktorë potencial që do të ndikojnë në shpeshtësinë e përplasjeve, e me këtë edhe shpejtësia e reaksionit. Përpiloni listë të faktorëve të këtyllë dhe në vazhdim përqendrohuni në to në këtë tërësi tematike.</li> <li>• Njoftoni me termin „energji e aktivacionit “ si energji të domosdoshme që të kryhet reaksioni.</li> <li>• <b>Përfundoni</b> se thërmijat duhet të përplasen që të vijë deri tek reaksioni. Ekzistojnë disa faktorë që ndikojnë në shpejtësinë e reaksionit.</li> </ul>	<p>Foto nga reaksionet kimike të ndryshme me shpejtësi të ndryshme, për shemb. eksplozivët, prishja e ushqimit, erozioni etj.</p> <p>Vërejtje: në këtë veb-faqe ka një numër të madh animacione të përdorshme me të cilat mund të shpjegohet shpejtësia e reaksioneve( duke e përfshirë teorinë e përplasjeve, energjinë e aktivizimit dhe mënyrat e shpejtësisë së reaksioneve) <a href="http://www.absorblearning.com/chemistry/demos/units/LR1501.html">http://www.absorblearning.com/chemistry/demos/units/LR1501.html</a></p>	<p>shpejtësi e reaksionit energji e aktivizimit përplasje temperatura përqendrimi(koncentracioni) thërmijë madhësia e thërmijës sipërfaqe katalizator ndikim reaktantë produkte zmadhon/zvogëlon ndryshore</p> <p>shpjegon përshkruan krahason përfundon parashtron hulumton</p>
Java 10	Ora e 2		

<p>E përdor teorinë e thërmijave që ta shpjegojë ndikimin e përqendrimit, madhësinë e thërmijave, temperatura dhe katalizatorët në shpejtësinë e reaksionit.</p> <p>Kryen vëzhgime dhe matje.</p> <p>Nxjerr përfundime.</p>	<p><u>Ndikimi i përqendrimit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkoni nga nxënësit le të parashikojnë çfarë ndikimi do të ketë zmadhimi i përqendrimit të reaktantëve në shpejtësinë e reaksionit.</li> <li>• Për nxënësit që e kanë më vështirë ta kuptojnë termin përqendrim, jepni detyrë që të kryejnë krahasim të ngjyrës së lëngjeve me përqendrim të ndryshëm të shurupit (lëng për tretje) në to. Mandej mund të vizatohen diagrame në të cilën do të jetë i paraqitur përqendrimi i thërmijave nga shurupi në çdo gotë.</li> <li>• Tregoni se shpejtësia e reaksionit varet nga përqendrimi i reaktanteve, për shembull, reaksioni i copëzave të mermerit me 1 mol dm<sup>-3</sup> acidi klorhidrik dhe me 2 mol dm<sup>-3</sup> acid klorhidrik. Mund të matet koha e nevojshme për formimin e vëllimit të gazit të caktuar.</li> <li>• Ose po, mund t'u tregoni animacion që e ilustron ndikimin e përqendrimit në shpejtësinë e reaksionit.</li> <li>• Nxënësit kryejnë hulumtim për kohën e nevojshme që një shirit magneziumi me gjatësi prej 3 cm të reagojë plotësisht në 25 cm<sup>3</sup> acid klorhidrik me përqendrime të ndryshme.</li> <li>• I evidenton rezultatet në tabelën.</li> </ul> <p>Mandej i analizojnë rezultatet e tyre që ta definojnë përfundimin në të cilën do të ishte e përshkruar se si zmadhimi i përqendrimit të reaktanteve ndikon në shpejtësinë e reaksionit.</p> <p>Nxënësit mund të shkruajnë barazimin për reaksionin e përbërë nga fjalët.</p>	<p>Ujë, shurup ( lëng për tretje ) (për shemb. shurup portokalli) dhe gota.</p> <p>Copëza mermeri, acidi klorhidrik ( 1 mol dm<sup>-3</sup> dhe 2 mol dm<sup>-3</sup>), kronometër (ose mjet tjetër për matjen e kohës së reaksionit).</p> <p><b>Vërejtje për siguri:</b> duhet të mbahet mbrojtje për sytë.</p> <p><a href="http://www.absorblearning.com/chemistry/demos/units/LR1503.html#Increasingconcentration">http://www.absorblearning.com/chemistry/demos/units/LR1503.html#Increasingconcentration</a></p> <p>Shirit magneziumi me gjatësi prej 3 cm, acid klorhidrik (me këto përqendrime : 0,25 mol dm<sup>-3</sup>; 0,5 mol dm<sup>-3</sup>; 1,0 mol dm<sup>-3</sup>; 1,5 mol dm<sup>-3</sup>; 2,0 mol dm<sup>-3</sup>), epruvetë për vlim (ose enë qelqi tjetër që ka kapacitet më të madh prej 25 cm<sup>3</sup>), menzurë (50 cm<sup>3</sup> ose 100 cm<sup>3</sup>), kronometër (ose mjet tjetërpër matjen e kohës së reaksionit).</p> <p><b>Vërejtje për siguri :</b> duhet të mbahet mbrojtje për sytë.</p> <p>На различни групи ученици може да им се</p>	<p>shpejtësi e reaksionit përqendrimi(koncentracioni) thërmijë përshpejton katalizator ndikim reaktantë zmadhon/zvogëlon ndryshore</p> <p>shpjegon përshkruan krahason përfundon parashtron vëzhgon pregaditje pajisje matje</p>
---	--	--	--

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit duhet të ushtrojnë ta zbulojnë simbolin/formulën e çdonjëres prej reaktenteve dhe produkteve. Këtë mund ta përdorin për formimin e barazimit nga simbolet/formulat kimike të reaksionit. <math>Mg + HCl \rightarrow MgCl_2 + H_2</math></li> <li><b>Përfundoni</b> se me zmadhimin e përqendrimit zmadhohet edhe shpejtësia e reaksionit.</li> </ul>	<p>Është i dhënë acidi me përqendrim të ndryshëm. Të gjithë të dhënat mund të mbledhen në një grup informacionesh për gjithë klasën.</p> <p>Vërejtje: në këtë fazë duhet nxënësit ta brazojë ekuacionin të përbërë nga simbolet/formulat. Do të mësojnë për barazimin e ekuacioneve të përbëra nga simbolet/formulat në gjysmëvjetorin e dytë.</p>	
<b>Java 11</b>			
<p><u>Java 11</u></p> <p>E përdor teorinë e thërmijave që ta shpjegojë ndikimin e përqendrimit, madhësinë e thërmijave, temperatura dhe katalizatorët në shpejtësinë e reaksionit.</p> <p>Zgjedh mënyrën më të mirë që ti paraqesë rezultatet.</p> <p>Përshkruan trendët dhe shabllonet (korrelacionet) që paraqiten në rezultatet.</p> <p>I interpreton rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë.</p> <p>Shpjegon rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë.</p>	<p><u>Ora 1</u> <u>Shpjegim për ndikimin e përqendrimit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><i>Si ndikonte përqendrimi i zmadhuar në shpejtësinë e reaksionit? Çka nënkuptohet nëse themi se përqendrimi është më i madh?</i></li> <li>Vërtetohen se nxënësit mund të shpjegojnë se përqendrimi paraqet numrin e thërmijave në njësi të vëllimit.</li> <li>Nxënësit zgjedhin se si ti paraqesin rezultatet të fituar nga ora e mëparshme. Nxënësit i përdorin grafikonet që i kanë vizatuar që të identifikojnë ndonjë trend në rezultatet( a.sh.q siç zmadhohet përqendrimi i reaktanteve, ashtu zmadhohet shpejtësia e reaksionit).</li> </ul> <p>Diskutoni për llojet e grafikoneve të zgjedhur nga nxënësit. Mund të fillojnë me vizatimin e diagramit të parregullt. Nëse në rezultatet vërehet ndonjë trend, atëherë mund të shtojnë linjë që më së miri i përgjigjet dhe me këtë të fitojnë grafikon linjar..</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit përdorin simulacione për studimin e ndikimit të përqendrimit në shpejtësinë e reaksionit.</li> </ul>	<p>Letër milimetrike.</p> <p>Kjo është mundësi për përforcimin e dijenisë nga lënda e matematikës nga klasa e VIII.</p> <p>Simulacioni „reaksionet dhe shpejtësitë“ <a href="http://phet.colorado.edu/mk/simulation/legacy/r">http://phet.colorado.edu/mk/simulation/legacy/r</a></p>	<p>shpejtësi e reaksionit përqendrimi(koncentracioni) thërmijë përshpejton katalizator ndikim reaktantë zmadhon/zvogëlon ndryshore</p> <p>shpjegon përshkruan krahason përfundon parashtron vëzhgon</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit vizatojnë diagrame që ta shpjegojnë ndikimin e përqendrimit në shpejtësinë e reaksionit me ndihmën e teorisë së thërmijave.</li> <li>Aktivitet plotësues. Nxënësit më të talentuar mund të shpjegojnë se pse zmadhimi i shtypjes së gazit është ekuivalent me zmadhimin përqendrimit.</li> <li><b>Përfundoni</b> se gjatë përqendrimeve më të mëdha ka më shumë thërmija në njësi të vëllimit, dhe prandaj ekzistojnë gjasa më të mëdha për përplasje të suksesshme si dhe zmadhim të shpejtësisë së reaksionit.</li> </ul>	<p><a href="#">eactions-and-rates</a> (Simulacioni është në dispozicion në gjuhën maqedonase, serbe dhe turke). <a href="http://www.kscience.co.uk/animations/collision.htm">http://www.kscience.co.uk/animations/collision.htm</a> <a href="http://www.physics-chemistry-interactive-flash-animation.com/chemistry_interactive/chemical_kinetics_factor_concentration.htm">http://www.physics-chemistry-interactive-flash-animation.com/chemistry_interactive/chemical_kinetics_factor_concentration.htm</a></p>	
<p><u>Java 11</u></p> <p>E përdor teorinë e thërmijave që ta shpjegojë ndikimin e përqendrimit, madhësinë e thërmijave, temperatura dhe katalizatorët në shpejtësinë e reaksionit.</p> <p>Përdor materiale dhe pajisje të ndryshme dhe merr masa për kujdes. Kryen vëzhgime dhe matje.</p> <p>Nxjerr përfundime.</p> <p>I interpreton rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë.</p>	<p><u>Ora 2</u> <u>Ndikimi i madhësisë së thërmijave</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Tregojeni ndikimin e madhësisë së thërmijave në shpejtësinë e reaksionit në atë mënyrë që do të mundoheni ta nderoni një sasi qumështi në pluhur (ose mjell ose çfarëdo produkti ushqimorë në pluhur) dhe do ta pluhurosni me pluhur (derdhni pluhur) mbi thuprën e ndezur që është përdorur për ndezje. Ose po, tregoni video inçizim (0:50 – grumbull pluhuri, 1:50 – pluhur). Kërkoni nga nxënësit ta paraqesin shkakun për dallimin që e vërejnë.</li> <li>Nxënësit kryejnë hulumtime vetanake për shemb.:</li> <li>Kryejnë krahasim të kohës së nevojshme që e njëjta masë e magnezit në pluhur dhe shiriti i magnezit plotësisht të reagojnë me acidin klorhidrik ;</li> <li>Krahasimi i parë i kohës së nevojshme që e njëjta masë e copëzave të mermerit me madhësi të</li> </ul>	<p>Shkopth i drurit, linjar i gjatë ose shkop, qumështi në pluhur.</p> <p><b>Vërejtje për sigurim :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Duhet të mbahen syze për mbrojtje.</li> <li>Nxënësit duhet të qëndrojnë anësh nga eksperimenti.</li> <li>Eksperimenti duhet së pari të jetë i provuar për të garantuar sigurinë.</li> </ul> <p><a href="https://www.youtube.com/watch?v=FBF7auCMv58">https://www.youtube.com/watch?v=FBF7auCMv58</a> (0:50 dhe 1:50)</p> <p>Shirit magneziumi me gjatësi prej 3 cm, acid klorhidrik (me këto përqendrime : 0,25 mol dm<sup>-3</sup>; 0,5 mol dm<sup>-3</sup>; 1,0 mol dm<sup>-3</sup>; 1,5 mol dm<sup>-3</sup>; 2,0 mol dm<sup>-3</sup>), epruvetë për vlim (ose enë qelqi tjetër që ka kapacitet më të madh prej 25 cm<sup>3</sup>),</p>	<p>shpejtësi e reaksionit përqendrimi(koncentracioni) thërmijë përshpejton katalizator ndikim reaktantë zmadhon/zvogëlon ndryshore</p> <p>shpjegon përshkruan krahason përfundon parashtron vëzhgon pregaditje pajisje matje</p>

	<p>ndryshme plotësisht të reagojnë me acidin klorhidrik;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kryejnë krahasim të kohës së nevojshme për tretje të plotë të tabletës kundër vlimit jo të mirë kur ajo vendoset e plotë, e përgjysmuar, dhe e ndarë në katër dhe në pluhur.</li> <li>• I evidentojnë rezultatet në tabelë.</li> </ul> <p>Mandej i analizojnë rezultatet e tyre që ta definojnë përfundimin në të cilën do të ishte e përkrahur se si zmadhimi i madhësisë së thërmijave të reaktanteve ndikon në shpejtësinë e reaksionit. Nxënësit mund të shkruajnë barazim të përbërë nga fjalët për reaksionin.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit mund të ushtrojnë zbulimin e formulës së çdonjërës nga reaktantet dhe produktet. Këtë mund ta përdorin për formulimin e barazimit nga simbolet/formulat kimike për reaksionet që i kanë hulumtuar.</li> <li>• <b>Përfundoni</b> se sa është më e vogël madhësia e thërmijave, aq është më i shpejtë reaksioni.</li> </ul>	<p>menzurë (50 cm<sup>3</sup> ose 100 cm<sup>3</sup>), kronometër (ose mjet tjetër për matjen e kohës së reaksionit).Ose , mund të përdoren copëzat e mermerit me madhësi të ndryshme me acid ose tableta kundër vlimit jo të mirë të ujit.</p> <p><b>Vërejtje për sigurim :</b> Duhet të mbahen syze për mbrojtje</p>	
--	--	--	--

## Java 12

<p><u>Java 12</u></p> <p>E përdor teorinë e thërmijave që ta shpjegojë ndikimin e përqendrimit, madhësinë e thërmijave, temperatura dhe katalizatorët në shpejtësinë e reaksionit.</p> <p>Zgjedh mënyrën më të mirë që ti paraqesë rezultatet.</p> <p>Përshkruan trendët dhe</p>	<p><u>Ora 1</u> <u>Shpjegim për ndikimin e madhësisë së thërmijave</u></p> <p>Pyetni nxënësit cila e ka sipërfaqen më të madhe: top letre(e pakeluar)ose top letre me të gjitha fletët e shpërndarë. Vërtetoni se nxënësit mund të shpjegojnë se thërmijat më të vogla zënë sipërfaqe më të madhe nga masa e substancës së njëjtë me thërmija të mëdha. Kjo është ekuivalente me sipërfaqen e topit të letrës e cila është më e vogël nga sipërfaqja e të gjitha letrave të veçanta..</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit zgjedhin se si ti paraqesin rezultatet të fituara nga ora e mëparshme. Ato i përdorin</li> </ul>		<p>shpejtësi e reaksionit përqendrimi(koncentracioni) thërmijë përshejton katalizator ndikim reaktantë zmadhon/zvogëlon ndryshore</p> <p>shpjegon përshkruan krahason</p>
--	--	--	---

<p>shabllonet (korrelacionet) që paraqiten në rezultatet.</p> <p>I interpreton rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë.</p> <p>Ka qëndrim kritik ndaj burimeve sekondare të të dhënave..</p> <p>Shpjegon rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë..</p>	<p>grafikonet që i kanë vizatuar që ta identifikojnë trendin e rezultateve (gj.gj. siç zmadhohet përqendrimi i reaktanteve, ashtu zmadhohet edhe shpejtësia e reaksionit).</p> <p>Diskutoni për llojet e grafikoneve të zgjedhur nga nxënësit. Përderisa është e nevojshme, shpjegoni nxënësve se nëse ndryshorja e tyre e pavarur është në kategori (përshemb. Zëmëdha/të mesme/ të vogla), atëherë nuk do të ishte e duhur të vizatojnë linjë që më së miri i përgjigjet. Për këtë lloj të të dhënave, më së miri është të përdoret diagrami shtyllorë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit përdorin simulacione për studimin e ndikimit të sipërfaqes në shpejtësinë e reaksionit.</li> <li>Nxënësit vizatojnë diagrame që ta shpjegojnë ndikimin e madhësisë së thërmijave në shpejtësinë e reaksionit.</li> <li><b>Përfundoni</b> se me shqyrtimin e substancave me thërmija më të vogla zmadhohet sipërfaqja. Sa është më e madhe sipërfaqja, aq është më e madhe gjasa për përplasje të suksesshme dhe me këtë zmadhohet shpejtësia e reaksionit.</li> </ul>	<p>Letër milimetrike . Kjo është mundësi për përforcimin e dijenisë nga lënda e matematikës nga klasa e VIII.</p> <p><a href="http://www.absorblearning.com/chemistry/demo/units/LR1502.html">http://www.absorblearning.com/chemistry/demo/units/LR1502.html</a>  <a href="http://www.freezeray.com/flashFiles/RatesOfReactionSurfaceArea.swf">http://www.freezeray.com/flashFiles/RatesOfReactionSurfaceArea.swf</a>  <a href="http://www.kscience.co.uk/animations/collision.htm">http://www.kscience.co.uk/animations/collision.htm</a></p>	<p>përfundon parashtron vëzhgon pregaditje pajisje matje</p>
<p><u>Java 12</u></p> <p>E përdor teorinë e thërmijave që ta shpjegojë ndikimin e përqendrimit, madhësinë e thërmijave, temperatura dhe katalizatorët në shpejtësinë e reaksionit.</p>	<p><u>Ora 2</u> <u>Ndikimi i temperaturës</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Kërkoni nga nxënësit të supozojnë se në çfarë rasti shkopi ndritës do të ndrisë më shumë shkëlqim, kur nata është e ftohtë ose e nxehtë.</li> </ul> <p>Vendosni dy shkopta ndritës, një në ujë me akull, dhe tjetrën në ujë të nxehtë. Shkopin e tretë mund të jetë e vendosur në temperaturë të dhomës për krahasim. <i>Cila</i></p>	<p>Shkoptha me dritë, ujë i nxehtë, akull kavanoz.</p> <p>Ose po, tregojuni foto për shemb. <a href="https://sciencewithtoys.wikispaces.com/Glow+sticks">https://sciencewithtoys.wikispaces.com/Glow+sticks</a></p>	<p>shpejtësi e reaksionit përqendrimi(koncentracioni) thërmijë përshejton katalizator ndikim reaktantë zmadhon/zvogëlon ndryshore</p>

<p>Zgjedh ide dhe bën plane detale për kontrollin të bazuar në dijeninë, të kuptuarit dhe hulumtimin e mëparshëm.</p> <p>Parashtron dhe përdor punë preliminare që të vendosë se si të kryhet hulumtimi.</p> <p>Vendos cila matje dhe vëzhgime janë të nevojshëm dhe cila pajisje duhet të përdoret.</p> <p>Vendos cila pajisje të përdoret dhe vlerëson çfarëdo risku dhe rreziku në laborator dhe hapësirat punuese.</p>	<p><i>është më me shkëlqim? Sipas nesh, cila do të zgjasë më gjatë?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegoni se temperatura ka ndikim në shpejtësinë e reaksionit që zhvillohet në shkopin ndritshëm.</li> <li>• Nxënësit supozojnë se cilat janë shkaqet për zmadhimin e vërejtur të shpejtësisë së reaksionit.</li> <li>• Nxënësit planifikojnë hulumtim të ndikimit të temperaturës në shpejtësinë e reaksionit. Në varshmëri nga resurset e përshtatshme, hulumtimet mund të kyçin : <ul style="list-style-type: none"> <li>• Trisulfat natriumi dhe acid klorhidrik( matet koha e nevojshme që shenja iks të zhduket);</li> <li>• Tretje e hidrogjenkarbonati i natriumit dhe tretja e klorur kalciumit (matet koha e nevojshme që shenja iks të zhduket);</li> <li>• Tretja e tabletës kundër vlomit jo të mirë në ujë me temperatura të ndryshme.</li> <li>•</li> <li>• Nxënësit mund ti planifikojnë hulumtimet e tyre në çifte ose në grupe të vogla. Duhet ti përcaktojnë ndryshoret e pavarura, të varura dhe kontrolluese dhe ta shënojnë metodën e hulumtimit. Metodat e tyre duhet të kyçin informatën për atë se sa herë do ti përsërisin matjet. Kërkoni nga nxënësit të rikujtohen në informatën kthyesë që e kanë fituar nga planet e tyre në klasën e VIII. Duhet ti përdorin ato informata kthyesë që ta përmirësojnë këtë plan.</li> </ul> </li> </ul> <p>Si pjesë e planeve të tyre, nxënësit duhet të shohin vallë është e nevojshme të kryejnë çfarëdo punë pregaditëse para se ta kryejnë hulumtimin e tyre, për shemb. të vendosin për përqendrimin e reagensëve që do ti përdorin.</p> <p>Nxënësit, poshtu, duhet ti identifikojnë risqet dhe rreziqet të cilat janë të lidhura me aktivitetet. Duhet të vendosin</p>	<p>Animacioni me këtë lloj të hulumtimit:  <a href="http://www.absorblearning.com/chemistry/demos/units/LR1504.html">http://www.absorblearning.com/chemistry/demos/units/LR1504.html</a></p>	<p>shpjegon përshkruan krahason përfundon parashtron vëzhgon pregaditje pajisje matje</p>
--	--	--	---



	<p>se cilat masa të kujdesit duhet të merren parasysh.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit ndërmjet veti i vlerësojnë metodat nën kornizat e grupeve të ndryshme. Ato duhet ndërmjet veti ti këmbëjnë informatat kthyesë në raport të asaj se vallë plani është detalisht i përpunuar. Vallë nga plani mundet qartë të vërehet: <ul style="list-style-type: none"> <li><i>Cila është ndryshorja e pavarur?</i></li> <li><i>Si ndryshorja e pavarur do të jetë e ndryshuar?</i></li> <li><i>Cila është ndryshorja e varur?</i></li> <li><i>Si do të matet ndryshorja e varur?</i></li> <li><i>Cilat janë ndryshoret kontrolluese?</i></li> <li><i>Si do të kontrollohen këto ndryshore?</i></li> <li><i>Sa herë do ti përsëritni rezultatet?</i></li> <li><i>Cilat janë masat e kujdesit?</i></li> </ul> </li> <li><b>Përfundoni</b> se temperatura është faktor i rëndësishëm në përcaktimin e shpejtësisë së reaksionit. Kjo mund të hulumtohet përmes eksperimenteve.</li> </ul>	<p><b>Vërejtje për siguri:</b> përdorimi i nxënësve do të punojnë sipas metodës së tyre vetanake gjatë orës së ardhshme, kjo duhet të jetë më parë i kontrolluar nga ana e arsimtarit.</p>	
--	--	--	--

<b>Java 13</b>			
<p><u>Java 13</u></p> <p>E përdor teorinë e thërmijave që ta shpjegojë ndikimin e përqendrimit, madhësinë e thërmijave, temperatura dhe katalizatorët në shpejtësinë e reaksionit.</p> <p>Kryen një numër të madh vëzhgimesh dhe matje që të zvogëlohet gabimi dhe rezultatet të jenë më bindëse.</p>	<p><u>Ora 1</u> <u>Hulumtim i ndikimit të temperaturës në shpejtësinë e reaksionit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Identifikoni mjetet punuese që janë në dispozicion nxënësve për hulumtimin e tyre dhe jepni pesë minuta që ti lexojnë planet e tyre dhe ti njoftojnë mjetet punuese që do të jenë të nevojshme, si dhe ta pregadisnin eksperimentin. Për atë kohë, ato duhet të japin supozim për rezultatet. Ky supozim duhet të kyc vizatimin e grafikonit në të cilën do të jetë e paraqitur forma që pritet.</li> <li>Ose, parashtron nxënësve metodë që të gjithë do ta përdorin në hulumtimin.</li> <li>Grupet e nxënësve kryejnë hulumtimin që ta tregojnë ndikimin e temperaturës në shpejtësinë e reaksionit. Shkoni nga njëri grup në tjetrin dhe jepuni</li> </ul>	<p>Mjete punuese për metodën e zgjedhur të hulumtimit.</p>	<p>shpejtësi e reaksionit energji e aktivizimit temperatura thërmijë përshpejton ndikim reaktantë produkte zmadhon/zvogëlon ndryshore</p> <p>shpjegon përshkruan krahason përfundon parashtron</p>

<p>Përdor materiale dhe pajisje të ndryshme dhe merr masa për kujdes.</p> <p>Kryen vëzhgime dhe matje.</p> <p>Zgjedh mënyrën më të mirë që ti paraqesë rezultatet</p> <p>Përshkruan trendët dhe shabllonet (korrelacionet) që paraqiten në rezultatet.</p> <p>I interpreton rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë.</p> <p>.</p> <p>Ka qëndrim kritik ndaj burimeve sekondare të të dhënave..</p> <p>Nxjerr përfundime.</p> <p>Shpjegon rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë. Quartë i ndan me të tjerët.</p>	<p>përkrahje.</p> <p>Mandej nxënësit i mbledhin dhe i interpretojnë rezultatet që i kanë fituar. Duhet të përpilojnë tabelë me rezultatet me hapësira të shprazta për matjet e sërishme. Duhet ti krahasojnë rezultatet me ato të grupeve tjera si dhe me supozimet e veta. Pyetni nxënësit vallë a munden të vërejnë ndonjë shabllon (ngjashmëri) në rezultatet të grupeve të ndryshme. Nxënësit duhet të vërejnë vallë a kanë disa rezultate me përjashtim nga matjet e sërishme. Përderisa ka rezultate me përjashtim, atëherë duhet të kryhet edhe një matje (nëse ka kohë).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nëse nuk ka kohë të mjaftueshme, atëherë mund të kryhet eksperimenti me simulacion që të arrihet deri tek rezultatet.</li> <li>• Nxënësit e paraqesin kohën nevojshme që reaksioni të mbarojë (ose <math>1/t</math>) ndaj temperaturës. E vizatojnë linjën që më së miri i përgjigjet dhe identifikojnë rezultatet me përjashtim. Ose, vizatojnë trafikonin duke përdorur të dhëna.</li> <li>• Nxënësit nxjerrin përfundime të thjeshta.</li> <li>• <b>Përfundoni</b> se zmadhimi i temperaturës e zmadhon shpejtësinë e përplasjeve dhe energjinë e përplasjeve. Me këtë zmadhohet gjasa për përplasej të suksesshme, a me këtë zmadhohet edhe shpejtësia e reaksionit.</li> </ul>	<p>Simulacioni „reaksionet dhe shpejtësitë“  <a href="http://phet.colorado.edu/mk/simulation/legacy/reactions-and-rates">http://phet.colorado.edu/mk/simulation/legacy/reactions-and-rates</a>  (Simulacioni është në dispozicion në gjuhën maqedonase, serbe dhe turke).  <a href="http://www.freezeray.com/flashFiles/RatesOfReactionTemp.swf">http://www.freezeray.com/flashFiles/RatesOfReactionTemp.swf</a> ( E mat kohën e nevojshme që të gjitha thërmijat e kaltërta të reagojnë në temperatura të ndryshme.)</p> <p>Letër milimetrike.  Letër punuese me të dhëna për kohën e nevojshme që reaksioni të mbarojë ndaj temperaturës .</p>	<p>vëzhgon  pregaditje  pajisje  matje</p>
<p><u>Java 13</u></p>	<p><u>Ora 2</u>  <u>Orë për përsëritje të materialit</u></p> <p>Orë për përsëritje të materialit për ndikimin e përqendrimit,</p>		

	madhësisë së thërmijave dhe temperatura në shpejtësinë e reaksioneve.		
<b>Java 14</b>			
<p><u>Java 14</u></p> <p>E përdor teorinë e thërmijave që ta shpjegojë ndikimin e përqendrimit, madhësinë e thërmijave, temperatura dhe katalizatorët në shpejtësinë e reaksionit..</p> <p>Kryen vëzhgime dhe matje.</p> <p>Përdor materiale dhe pajisje të ndryshme dhe merr masa për kujdes.</p>	<p><u>Ora 1</u> <u>Ndikimi i katalizatorit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Pyetni nxënësit ku e kanë dëgjuar termin „katalizator“. <i>Çka është katalizator?</i></li> <li>Tregoni se si shpejtësia e reaksionit varet nga prezenca e katalizatorit.</li> </ul> <p>Tregojuni nxënësve peroksid hidrogjenin në erlenmaer (ose ngjashëm).</p> <p>Tregojuni nxënësve barazimin të përbërë nga fjalët për zbërthimin e peroksidit të hidrogjenit. <i>Çka do të vërenin nëse reaksioni zvilloheshte shpejtë?</i></p> <p>Vërtetoni se nxënësit dinë se peroksidi i hidrogjenit zbërthehet (ngadalë) gjithë kohës. Tregoni nxënësve hapjen kapakut nga shishja laboratorike me peroksid hidrogjeni. Shpjegoni se funksioni i tij është që ti mundësojë dalje të gazit. Me rëndësi është që nxënësit ta kuptojnë se katalizatori e ndryshon shpejtësinë e reaksionit dhe nuk është reagens.</p> <p>Shtoni një sasi të vogël mangan(IV) oksit. Nxënësit le të vërejnë dallimin në shpejtësinë e reaksionit para dhe pas shtimit të katalizatorit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ose, tregoni nxënësve video incizim nga reaksioni..</li> <li>Nxënësit kontrollojnë materiale të ndryshme që të</li> </ul>	<p>Nxënësit ngamë parë kanë mësuar për enzime nga lënda e biologjisë. Poashtu, ndoshta kanë dëgjuar për konvertorë katalitik në sistemet për lirim të gazrave.</p> <p>Tretje e peroksidit të hidrogjenit, oksid mangani(IV), qelqe laboratorike.</p> <p><b>Vërejtje sigurimi</b> : duhet të mbahen syza për mbrojtje.</p> <p><a href="http://employees.oneonta.edu/viningwj/modules/CI_catalytic_decomposition_of_H2O2_15_14.html">http://employees.oneonta.edu/viningwj/modules/CI_catalytic_decomposition_of_H2O2_15_14.html</a> zbërthim i peroksidit të hidrogjenit në prezencë të oksid manganit(IV)(vërejtje:e dëmshme).</p>	<p>shpejtësi e reaksionit energjia e aktivizimit temperatura thërmijë përshpejton ndikim reaktantë produkte zmadhon/zvogëlon ndryshore</p> <p>shpjegon përshkruan vëzhgon krahason përfundon parashtron hulumton evidenton</p>

	<p>zbulojnë cilat janë katalizatorë për zërthimin e peroksidit të hidrogjenit. Ose, kjo mund të demonstrohet.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Përfundoni</b> se katalizatorët i shpejtojnë reaksionet kimike pa u harxhuar. Ato nuk janë reagens në reaksionin.</li> </ul>	<p>Tretje të peroksidit të hidrogjenit, substanca të ndryshme në gjendje agregate të ngurtë(për shemb. oksid mangani(IV), oksid hekuri(II), rërë) qelqe laboratorike.</p> <p><b>Vërejtje sigurimi :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Duhet të mbahen syze për mbrojtje.</li> <li>• oksid mangani(IV), është i dëmshëm nëse merret frymë ose gëlltitet.</li> </ul> <p><a href="http://www.rsc.org/learn-chemistry/resource/res00000831/hydrogen-peroxide-decomposition?cmpid=CMP00002415#!cmpid=CMP00000937">http://www.rsc.org/learn-chemistry/resource/res00000831/hydrogen-peroxide-decomposition?cmpid=CMP00002415#!cmpid=CMP00000937</a> video incizim me krahasim të katalizatorëve të ndryshëm (edhe inike edhe biologjike).</p>	
<p><u>Java 14</u></p> <p>E përdor teorinë e thërmijave që ta shpjegojë ndikimin e përqendrimit, madhësinë e thërmijave, temperatura dhe katalizatorët në shpejtësinë e reaksionit..</p> <p>Kryen vëzhgime dhe matje.</p> <p>Ka qëndrim kritik ndaj burimeve sekondare të të dhënave..</p> <p>Nxjerr përfundime.</p>	<p><u>Ora 2</u> <u>Enzimet janë katalizatorë biologjik</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkoni nga nxënësit ti paraqesin mënyrat në të cilën mund të zmadhohet shpejtësia e reaksionit. Në çifte , ato diskutojnë cilat nga të poshtëshënuarat paraqiten në sistemin digjestiv.</li> <li>• Zmadhimi i sipërfaqes.</li> <li>• Zmadhimi i përqendrimit të reaktanteve.</li> <li>• Zmadhimi i temperaturës.</li> <li>• Përdorimi i katalizatorit.</li> </ul> <p>Diskutoni përgjigjet. Vërtetoni se me përtypte zmadhohet sipërfaqja e ushqimit. Në lukth ka acid dhe ajo ka përqendrim të lartë. Me ndihmën e enzimave zmadhohet shpejtësia e një numri të madh të reaksioneve. Sidoqoftë, temperatura e trupit të njeriut mbetet 37 °C.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegoni se enzimet janë katalizatorë biologjik. Ato janë shumë të rëndësishme sepse mundësojnë që reaksionet të zhvillohen mjaftë shpejtë në</li> </ul>		<p>shpejtësi e reaksionit energjia e aktivizimit temperatura thërmijë përshpejton ndikim reaktantë produkte zmadhon/zvogëlon ndryshore</p> <p>shpjegon përshkruan vëzhgon krahason përfundon parashtron hulumton evidenton</p>

	<p>organizmat e gjallë (të cilat janë zakonisht në temperatura të ultë).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përsëriteni demonstrimin me zbrërthimin e peroksidit të hidrogjenit duke përdorur copë mëlçi e zezë ose patate të zier ose patate dhe copë mëlçi e zezë të zier ose patate e zier. Shpjegoni se në mëlçinë e zezë ose patate ka enzim që e shpejton zbrërthimin e peroksidit të hidrogjenit(emri i tij është kataliza). Me vlimin e mëlçisë së zezë ose patates ndalohet funksionimi i katalizatorit.</li> <li>• Siguroni nxënësve burime të informacioneve( të shtypura ose material nga interneti) për enzimet. Ato hulumtojnë shembuj me enzimet dhe reaksionet në të cilat shërbejnë si katalizatorë, për shemb.</li> <li>• amilaza</li> <li>• lipaza</li> <li>• ADN polimeraza</li> <li>• izomeraza</li> <li>• laktaza.</li> <li>• <b>Përfundoni</b> se enzimet janë katalizatorë biologjik. Ato mundësojnë që reaksionet kimike të zhvillohen mjaftë shpejtë në kushtet e një organizmi të gjallë..</li> </ul>	<p>Tretje e peroksidit të hidrogjenit, copë e vogël e mëlçisë së zezë ose patate, copë e vogël e mëlçisë së zezë të vluar ose patate të vluar, qelqe laboratorike.</p> <p><b>Vërejtje sigurimi:</b> duhet të mbahen syza për mbrojtje</p> <p>Vërejtje: mëlçia e zezë, ose patate,mund të përdoret si burim i enezimit kataliza. Patatja mund të jetë i pranueshëm për vegjeterjanët. Nëse përdoret mëlçia e zezë, atëherë merrni copë të vogël që shitet si ushqim(për shemb. mish pule,viçi, qengji ose derri.)</p> <p>Burime të informacioneve për nxënësit.</p>	
<b>Java 15</b>			
<p><u>Java 15</u></p> <p>E përdor teorinë e thërmijave që ta shpjegojë ndikimin e përqendrimit, madhësinë e thërmijave, temperatura dhe katalizatorët në shpejtësinë e reaksionit.</p>	<p><u>Ora 1</u> <u>Konvertorët katalitik</u></p> <p>Kërkoni nga nxënësit në çifte ta shpjegojnë dallimin ndërmjet termeve „katalizator“ dhe „enzim“. Vërtetoni se nxënësit kuptojnë që enzimet janë shembull për katalizatorë (gj,gj të gjitha enzimet janë katalizatorë, por jo dhe të gjithë katalizatorët janë enzime).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Siguroni nxënësve burime të informacioneve( të</li> </ul>		<p>shpejtësi e reaksionit energji e aktivizimit temperatura përqëndrim thërmijë madhësia e thërmijës sipërfaqe katalizator konvertor katalitik</p>

<p>Diskuton për mënyrën në të cilin sot punojnë shkencëtarët dhe si ato kanë punuar në të kaluarën, duke kyçur shembuj për eksperimente, dëshmi dhe të menduarit kreativ.</p> <p>Shpjegon rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë. Qartë i ndan me të tjerët.</p>	<p>shtypura ose materiale nga Interneti) për mënyrën e funksionimit të konvertorit katalitik. Ato i hulumtojnë reaksionet kimike që zhvillohen në sistemin e lëshimit të gazrave tek automjetet dhe përpunojnë poster ose prezentim.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Aktivitet plotësues. Nxënësit më të talentuar mund të hulumtojnë se si punon katalizatori (gj.gj katalizatori siguron rrugën alternative me energji të ulët të aktivacionit).</li> <li>• <b>Përfundoni</b> dhe katalizatorët janë të rëndësishme për një numër të madh të reaksioneve. Katalizatorët në sistemin e lëshimit të gazrave tek automjetet e zmadhojnë shpejtësinë e reaksionit ashtu që materiet ndotëse të dëmshme i shëndrrojnë në kemikale më pak të dëmshme.</li> </ul>	<p>Burime të informacioneve për nxënësit.</p>	<p>përshejton ndikim reaktantë produkte zmadhon/zvogëlon ndryshore</p> <p>shpjegon përshekruan krahason përfundon parashtron vlerëson</p>
<p><u>Java 15</u></p> <p>E përdor teorinë e thërmijave që ta shpjegojë ndikimin e përqendrimit, madhësinë e thërmijave, temperatura dhe katalizatorët në shpejtësinë e reaksionit.</p> <p>Përshekruan trendet dhe shabllonet (korrelacionet) që paraqiten në rezultatet.</p> <p>I interpreton rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë.</p> <p>.</p> <p>Ka qëndrim kritik ndaj burimeve sekondare të të</p>	<p><u>Ora 2</u> <u>Përsëritje për shpejtësinë e reaksionit</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkoni nga nxënësit ti paraqesin faktorët që mund të ndikojnë në shpejtësinë e reaksionit.</li> <li>• Nëpërmjet të diagrameve ose simulacionit në role, nxënësit përdorin ide nga teoria për thërmija që ta shpjegojnë ndikimin e ndryshoreve të ndryshme në shpejtësinë e reaksionit, gj.gj përqendrimi e zmadhon numrin e thërmijave, temperatura e zmadhon shpejtësinë e tyre dhe sipërfaqja e zvogëluar (për shemb. reaktantet të jenë në formë të grumbujve dhe jo si pluhur) e zvogëlon sipërfaqen në të cilën thërmijat mund të afrohen njëra tjetrës. Nxënësit mund të mendojnë simulacione vetanake në role me të cilat do ti shpjegojnë faktorët e ndryshëm.</li> <li>• Nxënësit identifikojnë shembuj me shpejtësi të ndryshme të reaksionit nga jeta e përditshme. Shembujt mund ta kyçin kohën e nevojshme për pregaditjen e patateve në varshmëri nga mënyra e</li> </ul>	<p>Opcionale: shembuj me receta, „e përdorshme</p>	<p>shpejtësi e reaksionit energjia e aktivizimit temperatura përqendrim thërmijë madhësia e thërmijës sipërfaqe katalizator konvertor katalitik përshejton ndikim reaktantë produkte zmadhon/zvogëlon ndryshore</p> <p>shpjegon përshekruan krahason përfundon parashtron</p>

<p>dhënave..</p> <p>Nxjerr përfundime</p> <p>I krahason rezultatet dhe metodat e përdorura nga të tjerët.</p> <p>Shpjegon rezultatet duke përdorur dijeninë dhe kuptimin shkencorë.</p> <p>Qartë i ndan me të tjerët.</p>	<p>pregaditjes (gj.gj. vaji arrin temperaturë më të lartë të ujit) dhe mënyra se si janë prerë patatet (çka ndikon në sipërfaqen).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit i mbushin letrat punuese në të cilën bëjnë krahasim të shpejtësive të reaksioneve të ndryshme. Shembujt mund të kyçin edhe përshkrime dhe diagrame, etj.</li> <li>Reaksioni i acidit me shiritin e magneziumit dhe magneziumit si pluhur;</li> <li>Dijagram në të cilën janë paraqitur madhësi të ndryshme të gungave.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit mbushin letra punuese me shprehje të gabuara që duhet të korrigojnë dhe shpjegohen sepse shprehja e parë është e gabuar.</li> <li><b>Përfundoni</b> se shpejtësia e reaksionit varet nga përqendrimi, temperatura, sipërfaqja dhe nga prezenca e katalizatorit. Teoria kinetike mund të përdoret për shpjegimin e shpejtësisë së reaksionit.</li> </ul>	<p>deri “ për ushqim të ngrirë, temperatura e rekomanduar për përdorimin e pluhujve të ndryshëm për larje etj.</p> <p>Letër punuese shembujsh në çifte. Në shembujt me çifte, njëri shembull duhet të ketë shpejtësi më të madhe të reaksionit nga tjetra.</p> <p>Letër punuese me shprehje që përmban gabime.</p>	<p>vlerëson</p>
<b>Java 16</b>			
<p><u>Java 16</u></p>	<p><u>Ora 1</u> Orë për përsëritje të materialit</p> <p>Orë për përsëritje të materialit tematik.</p>		
<p><u>Java 16</u></p>	<p><u>Ora 2</u> Orë për përsëritje të materialit</p> <p>Orë për përsëritje të materialit të gjithë gjysmëvjetorit.</p>		

# GJYSMËVJETORI I DYTË

## Tema 2A: 9.4 Formimi i lidhjes jonike dhe barazimi i ekuacioneve kimike

Kjo tërësi tematike ndërlidhet me atë që nxënësit më parë e kanë mësuar për lidhjet kimike, strukturën e atomit dhe konfiguracionin elektronik, valenca, metalet dhe jometalet, reaksionet kimike dhe të shënuarit e barazimeve të përbëra nga fjalët.

Nxënësit e zgjerojnë dijeninë e tyre me atë se do të mësojnë të bëjnë dallimin ndërmjet atomit dhe jonit dhe do ta kuptojnë formimin e joneve dhe lidhjes jonike. Mandej do ta zgjerojnë dijeninë e tyre për barazimet të përbërë nga fjalët dhe për barazimet të përbërë nga simbolet/formulat që ti shënojnë reaksionet kimike të barazuara të përbëra nga simbolet/formulat.

Hulumtimi shkencorë përqendrohet në :

- Përdorimi i materialeve të ndryshme dhe pajisjes si dhe marrja e masave për kujdes;
- Kryerja e vëzhgimeve dhe matjeve;
- Përshkrimi i trendëve dhe shablloneve (korrelacioneve) që paraqiten në rezultatet.



### Fjalët(termet) e rekomanduara për këtë temë

atom  
proton  
neutron  
elektron  
jep/pranon  
jon  
katjon  
anjon  
lidhja jonike  
tërheqje  
metal  
jometal  
grup  
valencë  
simbol/formulë  
komponim  
molekulë  
rregulla e kryqëzimit

Sistem periodik  
dyatomike  
ligji për ruajtjen e masës  
koeficient  
formulë  
barazim kimik  
ekuacioni kimik i barazuar  
shpejtësia e reaksionit

#### **Hulumtim shkencorë**

dallon  
hulumton  
vëzhgon  
përshkruan  
shpjegon  
parashikon  
krahason

Qëllimet e mësimit	Aktivitete të propozuara (sipas zgjedhjes)	Resurset	Terminologjia
<b>Java 1</b>			
<p><u>Java 1</u></p> <p>E përshkruan strukturën e atomit, duke e përfshirë numrin atomik, numrin e masës, shtresat elektronike dhe elektronet valentore.</p> <p>E përshkruan formimin e joneve( katione dhe anjone) me dhënien dhe marrjen e elektroneve nga ana e atomeve të elementeve nga grupi i parë dhe i shtatëmbëdhjetë.</p>	<p><u>Ora e 1</u> <u>Njoftimi me termin jone</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Filloni me atë që do ta shqyrtoni lidhshmërinë ndërmjet konfiguracionit elektronik dhe struktura e tabelës së sistemit periodik të elementeve. <i>Çka domethënë nëse elementi ndodhet në grupin e parë?</i> Përgjigjet duhet ta kyçin informacionin se ato kanë një elektron në shtresën e fundit. Nxënësit, poashtu, mund ta lidhin këtë me elementet që janë njëvalente.</li> <li>• Nxënësit e vizatojnë radhitjen e elektroneve në atomin e litiumit, duke e përfshirë edhe numrin e protoneve.</li> <li>• Shpjegoni se atomet tentojnë kah arritja e shtresës së fundit të plotë( që mund të lidhet me shembujt për lidhje kovalente ku atomet arrijnë shtresën fundit të plotë me ndihmën e elektroneve të përbashkëta.) <i>Si litiumi mundet të arrijë shtresën e fundit të plotë?</i> OShpjegoni se një elektron lirohet. <i>Si është ngarkesa e përgjithshme tani?</i> Për ilustrimin e kësaj, mund të përdoret simulim ose model.</li> <li>• Shpjegoni se kur ndonjë atom jep elektrone, krijohet joni që quhet kation. Nxënësit e shënojnë simbolin e kationit dhe konfiguracionin elektronik të tij.</li> <li>• Tani përsëriteni procesin me atomin e florit.</li> <li>• Nxënësit e vizatojnë radhitjen e elektroneve në atomin e florit. <i>Sa elektrone ka në shtresën e fundit? Si mund të arrihet shtresa e plotë e shtresës së fundit? Si është ngarkesa tani?</i></li> <li>• Shpjegoni se kur ndonjë atom pranon elektron,</li> </ul>	<p>Vërejtje: me rëndësi është që nxënësit të dijnë se atomet <i>lirojnë</i> ose <i>pranojnë</i> elektrone dhe fitohen jone. Kur flitet për lidhje kovalente, elektronet duhet të llogariten për të <i>përbashkëta</i>.</p> <p>Simulimi „Përpilo atom “ <a href="http://phet.colorado.edu/mk/simulation/legacy/build-an-atom">http://phet.colorado.edu/mk/simulation/legacy/build-an-atom</a> (Simulimi është në dispozicion në gjuhën maqedonase, shqipe,serbe dhe turke).</p>	<p>atom proton neutron elektron jep/pranon jon katjon anjon lidhja jonike tërheqje metal jometal grup</p> <p>dallon hulumton përshkruan shpjegon parashikon krahason</p>

